



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 1 PRILL 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
1 APRILA 2010. GODINE

PRILL – APRILA
2010

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 1 PRILL 2010

E enjte, 1 prill 2010, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

Deri në fillim të seancës plenare nuk kemi pranuar asnjë propozim për amendamentimin e rendit të ditës ose propozim për shqyrtim të një çështje urgjente në pajtim me rregullat procedurale. Pra, më lejoni që për pikën 5 të rendit të ditës - Ratifikimi i marrëveshjes për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës qeveritare Gjermane **KFW Frankfurt am Main**, e cila kërkon 80 vota të deputetëve, pasi në sallë kemi 91 deputetë, konsideroj që kemi një numër maksimal të deputetëve.

Pikën e pestë të rendit të ditës duhet radhitur si pikë të rendit të ditës. A jeni dakord? Jo të tretën, pas pyetjeve parlamentare, të parën, mirë të parën. Faleminderit! Kush është “për”. Faleminderit!

Pika e parë është:

**- Miratimi i procesverbaleve të seancës plenare të mbajtur më 4, 11
dhe 18 mars 2010**

Pyes, a ka vërejte në këto procesverbale?
Naim Rrustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Vërejtja ime është e drejtpërdrejtë, s’është vetëm e këtij procesverbali, po edhe të tjerave. Disa herë në Kuvendin e Kosovës diskutimet është kërkuar nga kryetari që të zgjasin 5 minuta. Unë po e lexoj Rregulloren e Kuvendit. Diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se 10 minuta për secilin deputet të Kuvendit, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe. Ju kisha lutur që kushti është në pjesën e parë të fjalisë, nëse vendos ndryshe, mund të vendosësh për më shumë se 10 minuta, një. Dhe, çështja e dytë, nuk është rregull demokratik që kryetari të propozojë që diskutimi të jetë më i shkurtër.

KRYETARI: Faleminderit! Ka vendosur Kuvendi dhe unë kam të drejtë të kërkoj nga Kuvendi ta shkurttojë diskutimin. Kuvendi ka vendosur dhe unë e respektoj Kuvendin. A ka vërejtje në procesverbal? Nuk ka. Konsideroj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura, më 4, 11 dhe 18 mars 2010. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

- Ratifikimi i marrëveshjes për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Qendrore Gjermane

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar marrëveshjen për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Qendrore Gjermane dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj ministrin Shala, si propozues i çështjes.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës ka pranuar grande nga Qeveria e Republikës Gjermane në shumën prej 16,5 milionë euro dhe kredi të butë prej 17 milionë euro. Mjetet janë ofruar përmes Bankës Gjermane për zhvillim që quhet KFW, Përkatësisht KFW Ky financim ka për qëllim ndërtimin e linjës 400 kilovoltëshe Prishtinë – Tiranë që është rreth 240 kilometra e gjatë dhe pjesa për Kosovën është rreth 35 kilometra e gjatë. Shpeshherë këtë projekt e kemi quajtur edhe autostrada energjetike dhe konsideroj me të drejtë që për objektiv ka uljen e kostos përmes optimizmit të operimit të përbashkët të dy sistemeve hidro dhe termo, përkatësisht hidro më shumë nga pjesa e Shqipërisë dhe termo nga ana e Kosovës.

Kjo i jep mundësi të shkëlqyer Republikës së Kosovës për të përmirësuar dhe shtuar eksportin e rrymës në Kosovës dhe qarkullim më të lehtë të energjisë të shkëmbyer nga mbarë rrjeti energjetik i regjionit.

Kjo kredi dhe pjesa e grantit do të na ndihmojnë në përmirësimin e parakushteve për krijimin e një tregu të integruar të energjisë me Evropën Juglindore.

Afati i shlyerjes së kredisë është 15 vjet. Për 3 vjet grejs periodë dhe me kushte të mira, përkatësisht kamata shumë të ulëta. Tash do t'i shpjegoj në detaje.

Ri pagesa e kredisë është në 24 këste çdo gjysmëvjetor në mënyrë proporcionale dhe të barabartë.

E para do të paguhet 6 muaj pas gatishmërisë së operimit të projektit, por jo më vonë se 30 dhjetori i vitit 2012. Interesi për kredinë do të paguhet në shkallën e përcaktuar nga KFW-ja dhe do të jetë 5,34% që konsideroj që si kamatë në kohën e tanishme është kamata më e favorshme që mund t'i ofrohet Republikës së Kosovës deri më tani.

Do të paguajmë një taksë të pakthyeshme të zotimit prej 0,25% vjetore në shumën të paderdhura të kredisë në fondet e Republikës së Kosovës.

Taksa e zotimit do të paguhet 3 muaj pasi që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi dhe do të paguhet në disporsime të plota të kredisë. Po ashtu do të paguhet në këtë gjysmëvjetor para datës së caktuar të ri pagesës kësti i parë për kredinë më 30 qershor deri më 30 dhjetor të çdo viti, duke filluar nga 30 qershori i vitit 2010.

Taksa e menaxhimit.

Republika e Kosovës do të marrë obligim që të paguajë KFW-së një taksë paushall të menaxhimit të pakthyeshme prej 1% të shumës së kryegjësë së të kredisë së cekur, domethënë për mënjanim të dyshimeve dhe operimeve të cilat mund të ndodhin gjatë operacionit rreth 17 mijë euro.

Dhe, më së voni kalimin e periudhës 3 mujore, pasi kjo marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, por çdo rast distribuimi i parë i këtyre fondeve do të bëhet sipas marrëveshjes siç e thamë, përkatësisht në çdo 6 muaj.

Kontributi financiar dhe i donacioneve.

Kontributi financiar, përkatësisht donacionet të cilat KFW-ja i ka afruar për Republikën e Kosovës është i pakthyeshëm, pra 16 milionë euro i kemi falas.

Duke marrë parasysh nevojën për ngritjen dhe zhvillimin e sektorit energjetik në Kosovë, përmirësimin dhe integrimin e sistemit transmisionit përmes linjës 400 kilovotëshe Prishtinë – Shqipëri, për dobinë që do të kemi ne si shtet si dhe kushtet shumë të volitshme të financimit, besoj se ky ratifikim do të ndihmojë zhvillimin e sektorit energjetik, sidomos para vendimeve të fuqishme që kemi në zhvillimin e këtij sektori.

Janë analizuar të gjitha rrethanat, KFW-ja është duke mbështetur edhe Republikën e Shqipërisë dhe linja prej Elbasanit, pjesa e Shkodrës deri në pjesën e Pejës, përkatësisht të Dukagjinit, janë duke u zhvilluar paralel edhe në pjesën e Shqipërisë dhe në pjesën e Malit të Zi.

Kjo autostradë energjetike do të ndihmojë zhvillimin e sektorit të energjisë dhe do t'i mënjanojë të gjitha fytet e ngushta të cilat janë të domosdoshme të zhvillohen, përkatësisht të mos ekzistojnë sidomos pasi që Kosova....

Ju ftoj që ta mbështesni. Faleminderit shumë.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të komisionit funksional, kryetari, deputeti Gani Koci, si raportues i Komisionit.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e dëgjuam kërkesën e ministrit lidhur me kredinë që i është akorduar Republikës së Kosovës, për destinacionin që e tha vetë ministri pra, unë konsideroj së ky është rezultati i parë ose sukcesi i parë pas asaj që ka ndodhur në qershor të vitit të kaluar të anëtarësimit të Kosovës në instrumentet monetare ndërkombëtarë dhe pa te ne ndoshta s'do të kishim mund ta realizojmë këtë kredi. Është thënë edhe më herët edhe më përpara, sepse është shumë e nevojshme ngritja e transmisionit ose linjës 400 kilovotëshe me Republikën e Shqipërisë që të konektohen ose interkonektohen dy sistemet edhe hidro edhe termo.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar këtë të them kontratë ose marrëveshje që duhet të ratifikohet në Kuvend dhe ju e dini shumë mirë edhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës edhe sipas Ligjit për borxhet publike, mënyrën se si procedohet dhe se si votohet në Kuvend, nuk do të lëshohem në atë që e arsyetoi vetë ministri, sepse arsyeja është më se e nevojshme edhe kushtet në të cilat lidhet kjo marrëveshje, po në emër të Komisionit konsideroj që Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta përkrahë këtë marrëveshje dhe mënyra se si duhej të votohej e keni për përcaktuar zoti Kryetar edhe me Ligjin për borxhet publike edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por që është i nevojshëm votimi, kjo nuk do koment i tha ministri.

Prandaj, lus deputetët e Kuvendit që ta votojnë këtë marrëveshje lidhur me këtë hua ose kredi me bankën në fjalë.

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Sipas radhës fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Ne kemi analizuar këtë marrëveshje dhe gjithsesi si grup parlamentar jemi për këtë gjë dhe jemi për ta ratifikuar, sepse i sjell dobi që u sqaruan për Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Sabri Hamiti, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah dhe do ta votojë ratifikimin e kësaj marrëveshje për kredi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Hamiti!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe grupi ynë parlamentar në parim e mbështet këtë marrëveshje, edhe pse konsiderojmë që është një marrëveshje që po ratifikohet shumë vonë, ka qenë më tepër se dy vjet në procedurat kur është kryer negocimi me Bankën Gjermane për zhvillim dhe njëkohësisht ne duhet të falënderojmë Bankën Gjermane për zhvillim për mbështetjen që i ka dhënë sektorit energjetik. Dhe, më vjen keq që dy vjet më tutje ne kemi mbetur peng të blerjes së energjisë nga vendet e rajonit me çmime të shtrenjta, sepse 400 kilovotëshi kishte ndihmuar shumë në blerjen e energjisë me çmime shumë më të lira nga vendet e ndryshme të rajonit.

Siç duket një vizion i tillë që ky 400 kilovoltësh të shtyhet, të prolongohet ka qenë më tepër një interes, ndoshta edhe dikujt tjerët që ne mos të krijojmë një lidhje të drejtpërdrejtë me Shqipërinë, që përmes kësaj lidhje të kemi edhe lidhje të tjera. Mendoj që këtu duhet të marrim kritika të ashpra për një vonesë tepër të madhe që e kanë bërë institucionet përkatëse, siç është Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Energjetikës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AKR-së, fjalën e ka deputeti Hëset Çakolli.

HËSET ÇAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për të gjithë ministrat,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka ky projekt për sektorin e energjisë, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, do ta mbështetë këtë marrëveshje në mes huamarrësit dhe kredidhënësit me të vetmin synim që Agjencioni për Ekzekutimin e Projektit KOSTT ta fillojë ekzekutimin sa më parë të këtij projekti shumë të rëndësishëm për vendin. Por, njëkohësisht kërkojmë që agjencioni për ekzekutimin e këtij projekti që në përputhshmëri me praktikën e shëndosha financiare dhe inxhinjerike të realizohet ky projekt sa më parë për shkak të rëndësisë që ka për sektorin e energjisë.

Mirëpo, ne si grup parlamentar njëkohësisht mendojmë se edhe mjetet e Trustit Pensional dhe Fondi i Privatizimit, ndoshta është mirë në të ardhmen të përdoren për financimin e projekteve kapitale e jo vetëm të futemi në kredi, por megjithatë është një projekt shumë me rëndësi dhe unë mendoj që duhet ta mbështesim. Ju faleminderit, zotëri.

KRYETARI: Fjala tani është për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë.

Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhja Demokratike e Dardanisë e përkrah këtë ratifikim të marrëveshjes duke ditur rëndësinë financiare të këtij projekti, por realisht procedurat janë të papranueshme, ne kemi pasur problem në procedura edhe në Komisionin për Buxhet. Materiali vjen një ditë para se ta shqyrtojmë në Komision, prandaj, kisha pasur me këtë rast ta jap një

vërejtje që vërtet së paku të mund t'i përcjellim procedurat të cilat i përcaktojnë edhe Rregullorja e Kuvendit edhe ligjet në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati, e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

Dozvolite da i ja u ime Grupe „7+“ pozdravim Kabinet vlade koji je u punom sastavu, Kolege i goste,

Naša Parlamentarna grupa se pridružuje parlamentarnim grupama koje prihvataju potpisivanje ratifikacije ovog sporazuma, smatrajući ga u ovom momentu neophodnim, kako je to rečeno, i dakle mi u ime Parlamentarne grupe podržavamo ratifikaciju ovog sporazuma.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, kryetari i grupit, Petar Miletqi, e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala!

I Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržava ratifikaciju ugovora.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të grupit Parlamentar për Integritet, deputeti Numan Baliq, e ka fjalën.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zotëri kryetar i Kuvendit,

Mi kao Parlamentarna grupa za Integraciju takođe podržavamo ovaj sporazum zato što ga smatramo važnim, zato što se radi o razvoju Kosova, zato što će doprineti boljem životu svih građana i, naravno, apeliramo na to da svi projekti ove vrste koji doprinose razvoju Kosova budu na dobro cijeloga Kosova, svih zajednica i svih djelovih regiona Kosova. Hvala vam lepo!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Për diskutim i kemi të lajmëruar tre deputetë. Fjalën e ka tani, sipas radhës, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë s'do të diskutoj shumë gjatë, po rreth pikës 3 të marrëveshjes së kredisë, te agjencioni thuhet se është i porsaformuar. Më intereson - a do të menaxhohet kredia nga Kosti apo nga Departamenti i Thesarit i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa?

Dhe, te pika 6, te taksa paushall, sigurisht duhet një sqarim. Nëse është 1% e kredisë së pakthyeshme, atëherë është 170 mijë euro, nëse është 01% është 17 mijë euro, siç tha edhe ministri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka sipas radhës, deputeti Ibrahim Makolli, le të përgatitet deputeti i fundit i paraqitur, Naser Rugova.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

U tha edhe në emër të Grupit Parlamentar që mbështesim marrëveshjen, por unë do t'i them dy gjëra sa i përket kësaj, thonë te ne që "fukaraja i mban dy shtëpia" dhe kjo po vërtetohet, sepse Kosova merr kredi me 5% kamatë, ndërsaq prej fondit të vet, prej Fondit pensional, Trustit Pensional dhe prej mjeteve të privatizimit, u japim të tjerëve me përqindje 2 ose 3%. Do të thotë, që është komplet në proporcion të zhdrejtë me këtë dhe prandaj do të duhej Qeveria që këto mjete t'i sjellë në Kosovë, t'i fusë në funksion të Kosovës dhe jo t'i japë dikujt mjete me 2 - 3%, sikurse që janë dhanë bankave këtu dhe ata na japin kredi pastaj me 15%, dhe po ashtu të mos marrë kredi të panevojshme sikurse që është kjo, ndërsaq mjetet tona të mbesin diku nëpër vendet tjera.

Dhe së dyti, po ashtu, praktika ndërkombëtare flet që normat për menaxhim të mjeteve në vendet e tjera janë 0.75%, ndërsaq te ne këtu kjo taksë e menaxhimit është 1%. Thjesht dhe Kosova nuk do të duhej që në këtë gjendje që e ka të shikojë sa më tepër që dikush mund të zhatë prej kësaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Po i pasuri s'mund të bëhet i pasur pa zhvatur dikë. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministri i Ekonomisë dhe Financave e zbërtheu në një farë forme kredinë e butë siç e quajti ministri. Sigurisht që asnjë shtet në tranzicion nuk është zhvilluar pa kredi dhe është normale që në logjikën e ekonomisë së tregut dhe zhvillimit sigurisht që të merren edhe kredi të tilla. Por, zotëri ministër kemi hyrë në vitin e tretë të qenit shtet dhe të pavarësisë, dihet që një periudhë të gjatë është biseduar lidhur me këtë kredi dhe kjo kredi tani po vjen edhe në prag të ardhjes së miratimit final të Strategjisë për energjinë e Kosovës, 2009 – 2018. Për mua është e çuditshme pse s'janë marrë hapa të tillë më herët si shtet i pavarur, sepse ju e dini mirë se sa paguan qytetari i Kosovës për t'u furnizuar me energji elektrike dhe dihet nga cilat kompani dhe dhashë Zoti që kjo kredi vërtet ta lidhë atë interkonencionin e famshëm me 400 kilovoltshëin në Elbasan dhe mos t'i merren parat kesh të buxhetit të Kosovës nga Rudnapi dhe kompani tjera që e dimë kush i menaxhon dhe ku shkojnë parat e taksapaguesve fukara të Kosovës.

Pastaj fondet e privatizimit dhe fonde të tjera që nuk dihet ku janë dhe nga opinioni marrim vesh që AUTP-ja i dërgon letër drejtorit të Bankës Qendrore apo guvernatorit, sepse ende nuk e dimë a është drejtor i Bankës Qendrore apo guvernator dhe ai po ashtu i kthen letër shefit apo kryetarit të Bordit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, që ju jeni ata që duhet t'i menaxhoni këto mjete dhe tani edhe projekte të tjera nacionale, po shkaktoni konfuzion. Mua më intereson, ministër, kush e menaxhon dhe e përcjell këtë kredi dhe fazat e operacionalizimit detal dhe te kjo taksa paushall nuk janë 17 mijë euro, por 1%, të 17 milionë, janë 170 mijë euro? Andaj, kishim pasur dëshirë për hir të transparencës t'i njoftojmë taksapaguesit kosovar, sepse buxheti i Kosovës ka për t'i kthyer mbrapa këto mjete. Vërtet, më në fund ka ardhur momenti që si shtet vërtet të jemi

të kujdesshëm dhe të kemi plane detale, pse po marrim kredi, ku po i dërgojmë, pse po paguhen dhe nuk është edhe aq kredi e butë një kamatë prej 5.34%, transferet, obligimet e bankave, taksat paushall e të tjera. Këtu po shihet që vërtet po kalon përqindja mbi 6.35%. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është fjala për sqarime, ndoshta të shkurtra, të ministrit Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit shumë për mbështetjen në parim.

Së pari dua t'ju sqaroj në pyetjet sipas radhës, do të jetë Departamenti i Thesarit sipas Ligjit mbi huan publike është Departamenti i Thesarit, në kuadër të Departamentit të Thesarit është Njësia për Përcjelljen dhe çdo administrim të ndonjë huaje publike që hynë Republika e Kosovës për të marrë. Konsideroj që kjo hua do të mundësojë, ashtu siç e thanë shumica, zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos energjetik. Kredia dhe kushtet e saja, duke marrë parasysh edhe grantin prej 16 milionë eurove që u dha është kredi e butë. Në qoftë se shikohen tregjet e sotme, sidomos për vendet që ende nuk kanë reiting, vendet që nuk kanë ende një histori për përcjelljen e kredive në vendet në tranzicion, kamata është e butë.

Neni 3.2 e përcakton shumë qartë dhe nenet vazhduese si dhe me aneks do të përcaktohet mënyra e saktë e kalkulimit të pjesës paushall, andaj do t'i marrë parasysh Geci dhe Armendi dhe pjesa tjetër e kritikave dhe sugjerimeve që u dhanë veç për sqarim zoti Çeku, ne kem nënshkruar kredinë më 23.12, pra, ndërsa të gjitha procedurat e vonesave, më vjen keq në qoftë se ka ndodhur vitet e kaluara, neve kemi proceduar me shpejtësinë më të madhe edhe shteti Gjerman ka pasur nevojë që këtë ta kalojë nëpër filtrat e vet burokratik, ndërsa ne më 23. 12 e kemi proceduar menjëherë për ratifikim në Parlament. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Një njoftim ose si këshillë juridike: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 18 - Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e 2/3 të të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare për këto çështje:

1. Territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake,
2. Të drejtat dhe liritë themelore,
3. Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare.
4. Marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.

Për ratifikimin e marrëveshjes, kërkohen së paku 80 vota "për".

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë ose përgatitemi për votim dhe votojmë, tash:

Prezentë janë 103 deputetë. Ju faleminderit!

Me 91 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës qeveritare gjermane, Frankfurt **am Main**

Nuk ka nevojë, janë 91 vota, tjetër herë merrni kartelat!

Vazhdojmë. Ju faleminderit!

Por, para se të fillojmë me pikën e radhës, pyetjet parlamentare, unë shfrytëzoj rastin që ministrave të rinj të Kabinetit qeveritar t’ua uroj detyrën e re dhe suksese në punën e tyre. Ju faleminderit!

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetjen e deputetëve për Qeverinë është kufizuar në 50 minuta. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Fillojmë me pyetjen e parë.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministren Justina Pula- Shiroka.

DRITON TALI: Zonja ministre!

Në fillim të këtij viti, mendoj në fillim të vitit 2009, më falni se pyetja është shumë e vonshme, patët deklaruar se Qeveria e Kosovës, ka marrë vendimin për reformimi në KEK-ut si parakusht të privatizimit. Po ashtu, patët deklaruar se që nga 15 prilli i vitit 2009, nga katër subjekt: prodhimi i thëngjillit, prodhimi i rrymës, rrjeti dhe furnizimit, do të krijohen dy kompani, njëri subjekt duke e bashkuar prodhimin e thëngjillit me atë të rrymës dhe subjekti i dytë duke e bashkuar distribuimin, shpërndarjen me furnizimin, me synim që distribuimi dhe furnizimi të privatizohen të parët, kështu që në shtatorin e vitit të kaluar, e keni regjistruar kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim të energjisë elektrike. Pyetja-KKDFE, çfarë kompanie është, kusht është drejtor ekzekutiv dhe kush e përbën bordin e saj dhe kur do të privatizohet? Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

XHAVIT HALITI: Ju faleminderit! Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA JUSTINA PULA - SHIROKA: I nderuar kryetar!

Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Kabinat qeveritar,

Deputetë,

Ju faleminderit, deputet Tali për pyetjen të cilën ma keni bërë, po unë mendoj ju jeni adresuar gabimisht. Është e vërtetë që në kuadër të grupit ndërministror qeveritar ku është edhe Ministria e Energjisë dhe e Minierave, kemi marrë vendim që të formohen dy kompani: Kompania e distribuimit dhe furnizimit dhe Kompania e gjenerimit dhe e linjitit.

Sa i përket kompanisë së dytë, është e vërtetë që është regjistruar dhe është duke funksionuar sa i përket aseteve, llogarive, mirëpo Bordi i drejtorëve ende nuk është përcaktuar për shkak të disa problemeve të cilat i kemi pasur për gjetjen e personave të cilët mund ta menaxhojnë mirë këtë distribucion.

Jemi në procesin e privatizimit, jemi duke bërë të gjitha përgatitjet, i kemi përzgjedhur këshilltarët e transaksionit të cilët janë duke punuar që ky transaksion të realizohet sa më mirë dhe në kohën të cilën është paraparë në kuadër të programit qeveritar. Mirëpo, nëse dëshironi të merrni detale më të mëdha rreth privatizimit apo rreth kompanisë, rrjetit dhe inkasimit, atëherë është më mirë të informoheni nëpërmjet të Njësisë për Implementimin dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, e cila është formuar në kuadër të Ligjit për ndërmarrjet publike.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Tali, dëshironi pyetje shtesë? Zoti Tali, urdhëroni!

DRITON TALI: Po, zoti kryesues!

Zonja ministre, unë që i bëj pyetjet të kësaj natyre zotit Ahmet Shala, që me të drejtë thotë se është përgjegjës, ai m'i adreson te ministrinë përkatëse, andaj unë nuk kam problem cilido nga Qeveria të ma jepni përgjigjen. Sidoqoftë, në bazë të asaj që thatë ju, Ligji për ndërmarrjet publike nuk lejon që një drejtor ekzekutiv dhe një ndërmarrje të jetë pa drejtor ekzekutiv për më se 8 muaj. Po ashtu, Qeveria pat deklaruar se kjo kompani është kompani pasive, atëherë po pyes ministrin Shala se çka është ndërmarrja pasive? Unë, sipas legjislacionit në fuqi nuk kam parë një nocion tjetër, dhe sa i përket asaj që jeni duke pritur njerëz, a jeni duke pritur njerëz e dëgjueshëm, domethënë, ata të cilët do t'i implementojnë urdhrat e shefave apo jeni me të vërtetë duke lypë njerëz të cilët do ta shtojnë këtë proces përpara dhe pse nuk na e bini Ligjin për privatizimin...?

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Shala, dëshiron të përgjigjet.

MINISTRI AHMET SHALA: Zoti kryesues,
Zoti Tali,

Ligji për ndërmarrjet publike i jep mundësi Komisionit ndërministror që, në fazën e tranzitore, përkatësisht në fazën e përkohshme, një ndërmarrje publike, përkatësisht një bord i një ndërmarrjeje publike, mund të veprojë si bord i pjesës së ndërmarrjes publike që deri në procesin e privatizimit, ndërsa procedurat e emërimit të atyre anëtarëve, janë konform pjesës së procedurave që Ligji i ndërmarrjeve publike jep. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Hyseni.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Zotëri ministër Hyseni!

Disa shtete të inklinuara miqësisht për dhe ndaj Republikës së Kosovës, të cilat e kanë njohur Republikën e Kosovës për shtet të pavarur dhe kanë ambasada në vendin tonë, gjithnjë nga qytetarët kosovar – kosovare, për aplikim dhe eventualisht për lejim të

vizës, kërkojnë formalitete të njëjta si edhe më parë, para njohjes së vendit tonë, madje kërkesat e tilla, ato shtete praktikojnë edhe nga personat që kanë pasaporte diplomatike, e për të qenë ironia edhe më e madhe, edhe atëherë kur janë të ftuar zyrtarisht nga organe autoritative të po atyre shteteve.

Zotëri ministër, si e komentoni këtë situatë ironike? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ministër!

MINISTRI SKENDER HYSENI: I nderuar deputet Smaka!

Të nderuar deputetë, kolegë,

Procedurat për pajisje me një vizë Schengen për qytetarët e Republikës së Kosovës, nuk dallojnë absolutisht nga procedurat që vlejnë për qytetarët e ndonjë vendi tjetër nga i cili kërkohet vizë për të hyrë në vendet Schengen. Në ndërkohë, që sa i përket vizave për pasaporta diplomatike dhe zyrtare, i nderuar profesor Smaka, mund të mos jeni në dijeni, unë po ju vë në dijeni ju dhe përmes jush edhe të gjithë anëtarëve të Parlamentit të Republikës se pas përpjekjeve që janë bërë kohëve të fundit dhe ngritjes së kësaj çështjeje në nivele të ndryshme, është arritur një pajtim dhe së voni, Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë, ka qarkulluar një notë verbale e cila mundëson përshpejtim të procedurave për dhënien vizash në të gjitha pasaportat diplomatike dhe zyrtare të Republikës së Kosovës. Kjo notë ka qarkulluar në shërbimet përkatëse të Kuvendit dhe unë ju ftoj që sa herë që të keni nevojë për vizë, t'i kontaktoni shërbimet përkatëse në Kuvend dhe ato t'i kontaktojnë shërbimet përkatëse të Ministrisë të Punëve të Jashtme, të cilët mjaftojnë të lëshojnë një notë dhe secilit bartës të pasaportës diplomatike, përkatësisht zyrtare, viza do t'i vihet në procedura shumë të shkurtuara. Ndërkohë që Ministria e Punëve të Jashtme, në secilin rast veç e veç e në veçanti me vendet që e ka njohur Kosovën, çështjen e njohjes të pasaportave dhe çështjen e vizave e ka pikë të përhershme të agjendës.

Deri me tash kemi qenë të suksesshëm që një marrëveshje për heqjen e vizave, heqjen e kërkesës për vizë ta arrimë me Republikën e Turqisë, po këto përpjekje janë në vijim edhe me një numër të madh shtetesh tjera të botës.

KRYESUESI: Ju faleminderit! A keni pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Dëgjova ekspozenë e zotëri ministrit Hyseni, po megjithatë e shpreh me të vërtetë një indinjatë. Kjo nuk i referohet individit, por çështjes të përgjithshme të shtetit tonë, që po e zëmë, një ndër shtetet e miqësisht të inklinuara, referuar Kosovës, e çështjes së Kosovës e që e ka ambasadën në Prishtinë, obligon edhe bartësit e pasaportave diplomatike të vejnë në një shtet tjetër, në një ambasadë tjetër, atëherë po del disi se kjo nuk qenka ambasada, por qenka si me thënë diçka, nën rangun a ambasadës, që nuk është fare mirë. Unë konsideroj që jeni angazhuar po do të duhej të super angazhohesh a ndryshe e theksoj edhe këtë qytetari i rëndomtë 4 ditë duhet t'i humbë, neto, prej mëngjesit deri në mbrëmje edhe s' e ka të sigurtë se do ta merrte vizën për të aplikuar për vizë. Edhe atë do të duhej të dalë jashtë shtetit tonë...

KRYESUESI: Zoti Hyseni!

MINISTRI SKENDER HYSENI: I nderuar, profesor Smaka, Shqetësimet tuaja besoj se i ndan secili anëtar i Kabinetit qeveritar, secili deputet, secili qytetar i Kosovës, se a jep viza në Kosovë një ambasadë e akredituar në Prishtinë ende apo jo, nuk është çështje thjesht politike apo e thjeshtë teknike, janë të dyja edhe politike edhe teknike. Derisa pengesat politike janë zgjidhur me vetë aktin e njohjes të Kosovës, shtet i pavarur dhe sovran, pengesat teknike janë ato me të cilat (profesor Smaka, unë ju dëgjova, besoj do të duhej të më dëgjoni), pengesat teknike janë çështje me të cilat ambasadat përkatëse janë duke u marrë këto ditë. Siç mund të jemi në dijeni, Ambasada e Republikës të Sllovenisë ka filluar rishtazi të japë viza në Prishtinë dhe kjo do të ndodhë edhe me ambasadat tjera, mirëpo janë çështje që bien në kuadrin e përgatitjeve të domosdoshme teknike dhe nuk mund të ndodhë shpejt. Është krejt e natyrshme, Kosova, është shtet pak më shumë se dy vjet dhe në këtë periudhë kaq të shkurtër, shtetet e ndryshme të akredituara diplomatikisht në Prishtinë, nuk kanë pasur mundësi t'i bëjnë të gjitha përgatitjet e duhura teknike për të lëshuar viza në Prishtinë, mirëpo ka një trend pozitiv dhe ky trend pozitiv duhet të na gëzojë të gjithëve. Të gjitha ambasadat do të japin shpejt viza në Prishtinë, ato që janë në Prishtinë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Nenad Rashiq

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Të nderuara qeveritarë, deputetë,

Zotëri Rashiq, nga kontaktet e mia me qytetarët, ndër të tjera, kam informata se në Pejë, konkretisht, me adresë, me emër e me mbiemër, krejt janë në fusnota dhe në referenca. Një familje shqiptare katër anëtarësh jeton në kushte jetësore skamnore, pa asnjë burim të të ardhurave, madje në një ambient të improvizuar, sepse shtëpinë e asaj familje e kanë djegur paramilitarët serbë gjatë vitit 1999. Dy familje serbe, po ashtu skamnore me atë që ballë për ballë me këtë, këto të fundit rregullisht marrin ndihma materiale, financiare. Ju lutem, një pamje, me të vërtetë irituese. Si mund të tolerohet një diskriminim i tillë? Të dhënat janë fakte, janë të të gjitha, i keni të prezantuara edhe në fusnota edhe në komente.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI NENAD RŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovani premijeru,

Poštovani zamenici premijera,

Kolege ministri,

Gospodine Smaka,

Kao što verovatno vi treba da znate, od početka 2009. godine, sistem socijalne pomoći je decentralizovan na same opštine, koje su po tom zakonom trebale da bolje nadgledaju taj sam rad te socijalne pomoći i način na koji mogu da pomognu svojim sugrađanima jer se pretpostavlja da su oni bliže svojim građanima. Ja stvarno ne znam za ovaj slučaj. Mi doduše imamo zadatak monitoringa svih tih lokalnih institucija i lokalnih opština koje implementiraju ove socijalne pomoći, tako da ako mi dostavite konkretne podatke, mi

ćemo sigurno da se potrudimo da se tako nešto ne dešava, ali u svakom slučaju ponavljam, socijalne pomoći su Zakonom od 2009. godine, apsolutno prebaćene na lokalne institucije. U ovom slučaju, ukoliko mi date imena i, naravno, broj slučaja, mi ćemo našim centralnim autoritetom intervenisati da se takve stvari ne dešavaju. Hvala!

KKRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Smaka, a dëshironi pyetje shtesë?

RIZA SMAKA. Po, faleminderit! Kam respekt, konsideratat për angazhimet edhe pikëpamjet e zotëri ministrit Rashiq. Mirëpo, ju lutem nuk është mirë që të apelohe mi në atë se janë kompetenca komunale. Administrata shtetërore sipas ligjit edhe sipas parimeve të drejtës administrative ka ingerenca, ka jurisdikcion të mbikëqyrjes administrative edhe të ligjshmërisë. Le t'i aplikojë ato edhe le t'i korrektojë, po e zëmë këto, se ky nuk është një shembull, ky është shembull që tregon për një dukuri. Nuk kam qenë, nuk jam edhe kurrësi nuk do të jemi për kurrfarë diskriminimi, as pozitiv as negativ, jemi qytetarë të barabartë, prandaj duhet ta kemi tretmanin e njëjtë, ju lutem pavarësisht nga etnikumi, e religjioni e këto, si me përkatësi tjera. Ju falënderohem shumë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Dëshironi? Nuk ka përgjigje shtesë. Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për ministren Justina Pula- Shiroka.

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit!

Çështja, paralajmërimi për rritjen e energjisë elektrike prej muajit prill 2010, për 14.6%. Pyetja qëndron, në çfarë indikatori jeni bazuar për rritjen e rrymës elektrike prej 14.6% kur dihet se gjysma e popullatës jetojnë në varfëri dhe a keni krahasime me vendet e rajonit në relacionin paga mesatare dhe vlera e pagesës së rrymës për 1 kilovat rrymë të shpenzuar? Për shembull, sa është paga mesatare në Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni dhe sa paguajnë për 1 kilovat rrymë të shpenzuar?

KRYESUESI: Zonja Pula!

MINISTRJA JUSTINA PULA- SHIROKA. E nderuara deputete, me siguri këtë pyetje e keni bërë para një kohe, mirëpo nuk keni mundur të merrni përgjigjen e duhur, më 26.03, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në bazë të aprovimit të Bordit të tyre, na kanë sjellë vendimin që nuk do të ketë shtrenjtim të energjisë elektrike.

KRYESUESI: Ju faleminderit! A keni pyetje shtesë, zonja deputete? Jo. Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministren Justina Pula- Shiroka.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!

Në muajin tetor të vitit 2009, KEK-u mori vendim për të ndërprerë furnizimin me rrymë në pjesën veriore të Kosovës. Qytetarët gjenden para një situatë të mos informimit se a vepron KEK-u në tërë territorin e Kosovës, ashtu siç ishte shprehur Kryeministri më datën 22 tetor 2009, me ftesën për të gjithë. Po e citoj: "Qytetarët që të respektojnë Ligjin dhe vendimet që kontribuojnë në kthimin e normalitetit në vend" dhe të

nesërmen, më 23 tetor, “Elektroprivreda Serbie” merr nën kontroll ... dhe depërton edhe më shumë në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve në veriun e Kosovës.

Duke filluar nga nëntori i vitit 2009, në komunat në veriun e Kosovës, Elektroprivreda Serbie bën faturimin e energjisë elektrike.

Pyetja- Si dhe pse u mor ky vendim që rezultat e pati futjen e Serbisë edhe më thellë në jetën e qytetarëve të Kosovës? Cilat janë arsyet e juaja që mund t’i ofroni këtij parlamenti pse lejohet Elektroprivreda Serbije të operojë në Kosovë?

KRYESUESI: Zonja ministre!

MINISTRJA JUSTINA PULA- SHIROKA: I nderuar deputet Tali, ju po e bëni pyetjen, më falni se zakonisht vetëm ju të dytë po i bëni pyetjet, për atë Tali, zakonisht është njëjtë, ai flet, ti mendon, kështu që për mua është krejt njëjtë, prandaj Driton nuk është. Mirë, mirë gabova, na falni, por njëjtë. Njëri flet, tjetri e mendon, kështu që për mua është krejt njëjtë.

Korporata Energjetike e Kosovës KEK-u, është korporatë e licencuar dhe e vetmja e cila operon në Kosovë, në tërë territorin e Kosovës dhe qëllimi i saj është të furnizohen të gjithë konsumatorët me energji elektrike. Licencën të cilën e ka Korporata energjetike Kosovës e merr nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, i cili është i vetmi institucion i pavarur dhe i përgjigjet vetëm Kuvendit. Ne në kuadër të grupeve ndërministrore për ndërmarrjet publike, jemi duke punuar dhe jemi vazhdimisht në kontakt me Bordin e Korporatës që t’ju mundësojë atyre që të veprojnë në tërë territorin e Kosovës dhe t’i plotësojnë objektivat të cilat ai ka Qeveria dhe KEK-u, t’i furnizoj konsumatorët me energji elektrike dhe të jetë sa më afër konsumatorëve.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Dëshironi pyetje shtesë, zoti deputet! Deputetët Rrustemi, fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Me ju thënë të drejtën, nuk e kuptova shumë, do të punojmë, do t’ia bëjmë, por gjendja reale e thotë të kundërtën. Pyetja ime shtesë kishte me qenë se - a janë objektivat e vërteta të Qeverisë, kjo çka në të vërtetë po ndodh që të futet edhe Elektroprivreda Serbije në veri të Kosovës? A është pjesë e politikave qeveritare dhe a është pjesë e strategjisë për Veriun e Kosovës?

KRYESUESI: Ministre!

MINISTRJA JUSTINA PULA- SHIROKA: Politikat e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe e tërë Qeverisë, janë që t’i furnizojë të gjithë konsumatorët me energji elektrike. Kjo është përgjigja e saktë. Sa i përket strategjisë së veriut, më duket nuk ma keni bërë atë pyetje. Tjera herë kur e bëni, mundem t’ju përgjigjem.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Ju faleminderit!

Në vitin 2009, zoti ministër, PTK-ja shpalli fituesit e një tenderi shumë kontraverz për operatorin virtual Konsorciumin Dardafon. Por, kohë më parë u bë publike se PTK nënshkroi kontratë me Dardafon.net. Për shkak të shumë konfuzioneve në opinion, ju lutem a do na qartësoni se kush e fitoi tenderin, Dardafoni apo Dardafoni.net dhe më lejoni disa informata shtesë për opinionin. Dardafoni është regjistruar në RBK si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, me numër të biznesit 70401181, adresa “Vëllazërim Bashkim” numër 168 Pejë, e licencuar për operator virtual në vitin 2008, ndërsa Dardafon.net është regjistruar po ashtu si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër të biznesit 705408789, adresa Miradija e Epërme, Fushë Kosovë, e licencuar për operator virtual në janar të vitit 2010, por kemi të bëjmë me dy ndërmarrje të ndryshme me përgjegjësi të kufizuara.

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar, zoti deputet Tali!

Konsideroj se në këtë pyetje më duket se jemi përgjigjur edhe një herë, por megjithatë më lejoni që të ritheksoj se operatori Dardafon ka qenë operator që ka marrë licencën nga ART-ja, me të cilën Posta dhe Telekom i Kosovës ka lidhë kontratë. Me licencimin edhe të operatorit me emër Dardafon.net, të cilin e ka licencuar ART-ja, PTK-ja, sipas informatave që kam dhe që e kam konfirmuar edhe sot, ka vazhduar të bëjë të njëjtën kontratë që ka pasur me Dardafon.net. Këto janë informata që i kam marrë unë nga ART-ja dhe nga Postë-Telekomi i Kosovës, me shkrim. ART-ja është institucion që ju përgjigjet juve këtu dhe mund ta thirrni në çdo kohë për t’i dhënë sqarimet të cilat janë në konfirmim të plotë me procedurat dhe ligjet që i ka ART-ja në fuqi.

KRYESUESI: Ju faleminderit! A dëshironi pyetje shesë?
Zoti Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Unë shpresoj se këto që i thatë, i ka dëgjuar Iv de Kermabo, shefi i EULEX-it, sepse po kërkon fakte për korrupsion. Ju e keni kastruar Ligjin për afarizëm. Si mund që një ndërmarrje, një person juridik, i pavarur, ta fitojë së pari tenderin edhe krejt një ndërmarrje tjetër juridike, pra një ndërmarrje ... ta marrë atë tender? Është dashur që ai tender të ri tenderohet edhe një herë e jo t’i jepet krejt tjetërkujt, kjo është korrupsion me dy këmbë. Unë shpresoj se Ive de Kermabo është kah më dëgjon, ky që po lyp, ky zotëriu s’ ka bërë kurrigjë hiq e po lyp hala për t’ ia zgjatur afatin në Kosovë, fakte ka lypur, ja ku e ka faktin, le ta lypë atje. Një ndërmarrje e pavarur apo shoqëri e pavarur, me këso farë si po i thoni ju në anglishte limited liability companies L.L.C apo LTDs, me përgjegjësi të kufizuara, nuk mund t’ia marrë tenderin një ndërmarrje krejt tjetër, një shoqërie tjetër apo një ndërmarrje tjetër me përgjegjësi të kufizuara. Kjo është ...

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Shala, a dëshironi fjalën!

MINISTRI: Unë vetëm do t’ju lusja që për të gjitha këto të kontaktoni me ART-n, i cili është institucion i juaj dhe me të cilin besoj, duhet të vendosni, absolutisht, kushdo qoftë atje, le t’i shikojnë gjërat se cili është përgjegjës para Ligjit, konform ligjit, jo

konform spekulimeve e tjera që bëhen, por do t'ju kisha lutur që ART-n ta thirrni që të japë shpjegimet e nevojshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër! Deputetja Gjylnaze Syla pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

I nderuar zoti kryesues,

E nderuar Qeveri e riformatizuar,

Pyetja ime ka të bëjë me çështjet e dëmeve të luftës. Në luftën e fundit në Kosovë Serbia i ka shkaktuar dëme të mëdha Kosovës në njerëz, në pasuri dhe ekonomi. Sipas të dhënave të organizatave ndërkombëtare, gjatë luftës në Kosovë janë vrarë 12.000 njerëz, 5602 janë zhdukur, janë djegur 120.000 shtëpi. Ekonomia pothuaj se është shkatërruar tërësisht, është plaçkitur Fondi Pensional dhe kursimet devizore. Prandaj, Kryeministër Thaçi, a ka grumbulluar Qeveria të dhëna për dëmet e luftës që ka shkaktuar Serbia në Kosovë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete Syla,

I nderuar kryesues,

Fillimisht, më lejoni që pas riformatizimit afirmativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, t'i falënderoj njëherë ish- ministrat për punën tyre e tyre të bërë në këto dy vjet , por edhe në të njëjtën kohë t'i uroj ministrat e rinj për përgjegjësitë e reja që kanë marrë.

E nderuara deputete Syla, të dhënat që u prezantuan këtu, nuk janë ndonjë e dhënë diçka e re pasi që i dimë të gjithë pasojat që i janë shkaktuar Kosovës dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës nga lufta, pra nga Serbia. Ato dëme u përmendën edhe nga ju, janë përmendur shpesh edhe para jush edhe nga ne. Ne kemi luftuar të gjithë së bashku për ta parandaluar dhe dëbuar forcat serbe nga Kosova, për ta fituar lirinë, për ta shpallur Kosovën shtet dhe tash me hapa të sigurt për t'u integruar në NATO dhe Bashkim Evropian. Sot Kosova është ndërtuar dhe është duke u rindërtuar shumë, të arriturat janë të jashtëzakonshme, nuk është ky vetëm vlerësim i imi, por është vlerësim edhe i gjithë botës demokratike. Janë ndërtuar shtëpi të reja, godina të reja, në masë të madhe është ndërtuar para së gjithash, duhet kuptuar edhe mirëkuptimi në një formë është investuar që të kemi një pajtim në veçanti të qytetarëve të Kosovës, të shqiptarëve, të serbëve. Megjithatë, ne kemi shumë çështje të hapura, këtu përfshihet edhe çështja e luftës në Kosovë në raport me Beogradin.

Qeveria e Kosovës gjithmonë ka qenë dhe të gjitha institucionet tona kanë qenë të përkushtuara që të bashkëpunojnë për çështje të mbetura dhe të hapura në mes të Kosovës dhe Serbisë, së bashku gjithmonë edhe me bashkësinë ndërkombëtare, atë që mund t'ju them sot për krimet e luftës, është se do të ndëshkohen ata që kanë kryer krime, disa edhe janë ndëshkuar, por unë do të vazhdoj dhe Qeveria që e udhëheq unë të zotohet për drejtësi, të zotohemi që para Ligjit do të ballafaqohen të gjithë njerëzit që

kanë kryer krime. Ne nuk do të kërkojmë që të rihapim konflikte në asnjë rrethanë, por drejtësia, ndëshkimi i keqbërësve do të jetë ai që e mbyll kapitullin e errët të luftërave në rajonin tonë, por para se gjithash është mirëkuptimi dhe pajtimi ai që mbyllë të kaluarën e hidhur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetes Sylja fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryeministër,
Më mirë të ishit koncentruar se çfarë ju pyeta se sa që ishit duke folur në telefon. Pyetja ime ishte për dëmet ekonomike në vend dhe në njerëz. Është e qartë që nuk keni mbledhur të dhëna. A do të thotë kjo që nuk do të jeni në gjendje të ngrehni padi kundër Serbisë?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, dëshironi të vazhdoni?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ne kemi bërë shumë e shumë për vendin tonë edhe me largimin e Serbisë nga Kosova. Ne jemi në partneritet shumë të ngushtë me të gjithë miqtë ndërkombëtarë e në të njëjtën kohë jemi të vetëdijshëm për hapat që po i ndërmarrim si shtet, prandaj dëmet janë të evidentuara dhe do të marrim qëndrim në kohë të duhur shtetëror edhe sa i përket çështjes që ju e ngritët.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Safete Hadergjonaj, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Një nga prioritetet kryesore në komunën e Deçanit, që nga paslufta ka qenë projekti i kanalizimit të ujërave të zeza. Deçani nuk ka pasur përkrahje nga asnjë qeveri për ta realizuar këtë projekt. Gëzon fakti që më në fund kjo Qeveri ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me komunën për investime të përbashkëta. Në buxhetin e vitit 2010, nuk ka mjete të ndara për këtë projekt, por as në parashikimet për 2 vjetët e ardhshme.

Pyetja ime është kjo- Kjo marrëveshje për investime, është një dëshirë, marketing politik apo është fjala për një projekt të mbështetur në kosto financiare?

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendësministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Hadergjonaj,

Së pari, dua t'ju njoftoj se komuna e Deçanit nuk ka fare kanalizim dhe ajo gjendje është e patolerueshme në kohën tonë moderne, si dhe kjo marrëveshje ka ardhur si rezultat i financimit të përbashkët në mes të Komunës së Deçanit dhe Ministrisë për Mjedis dhe

Planifikim Hapësinor, ku e tërë kjo ishte bërë në koordinim të ngushtë me Zyrën e zëvendëskryeministrit të Republikës së Kosovës, zotëri Kuçi.

Fillimisht projekti është hartuar dhe përgatitur nga vetë komuna e Deçanit. Gjithashtu, për vitin 2010, kjo komunë në buxhetin e vet e kishte të paraparë si investim kapital dhe kishte ndarë buxhet prej 400.000 euro, kurse pjesën tjetër e kemi marr për obligim që ne si Qeveri qendrore t'i sigurojmë mjetet për vitin 2010, që llogaritet vlera investive për këtë vit të jetë rreth 1.000.000. Do të bëjmë përpjekje që të sigurohen mjetet, në rend të parë pas rishikimit të buxhetit gjatë muajit qershor të këtij viti dhe do të hulumtohen edhe format tjera të financimit siç mund të jenë për shembull donacionet e ndryshe.

Realisht, pas sigurimit të mjeteve nga komuna e Deçanit, janë pjekur kushtet që të fillojë procedura e tenderimit që të zhvillohen punët. Gjithashtu më duhet të theksoj se Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, krahas projekteve tjera në mjedis, në KASH 2010-2012 dhe në Projekt-propozimin e buxhetit të vitit 2010, të cilin e kemi dorëzuar në MEF, e kemi paraparë këtë investim edhe atë sipas vlerave nëpër vite. Për vitin 2010, kanë qenë paraparë 1.300.000 kurse për vitin 2011 kanë qenë të parapara 500.000, që gjithsej shuma totale është 1.800.000, i cili është llogaritur për përfundimin e këtij projekti, natyrisht që kërkesa jonë për ndarje buxhetore për vitin 2010 nuk ka kaluar e tëra nga ana e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, ka pasur reduktime të projekteve, por nuk do të thotë se kjo gjatë rishikimit buxhetor nuk do të ketë mundësi të sigurohen mjetet për këtë qëllim.

Sa i përket marketingut politik, unë jam kryetar i Partisë Demokratike Turke, jam ministër i Mjedisit, kështu që ndoshta nuk kam nevojë për marketing politik.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Dëshironi pyetje shtesë? Deputetes Hadergjonaj fjalën!

SAFETE HADERGJONAJ: Unë nuk kam ndoshta ndonjë pyetje kështu shtesë, unë e falënderoj shumë ministrin për përgjigjen që na e dha dhe e përgëzoj edhe ministrin edhe Qeverinë për këtë iniciativë që kanë marrë për t'iu qasur me seriozitet kësaj çështje mjaft jetike për banorët e komunës së Deçanit dhe uroj që sa më shpejtë këto mjete të jenë në buxhet, në buxhetin të cilat i dedikohen pikërisht këtij projekti dhe të realizohet ky projekt në komunën tonë, që është e vetmja komunë që nuk e ka të zgjidhur këtë problem. Ju falënderoj shumë për iniciativën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Sigurisht, ne këtë vendim e kemi marrë për të realizuar dhe besojmë, që edhe me rishikimin e buxhetit edhe mundësive tona të brendshme, do të fillojmë këtë vit edhe në vitin e ardhshëm do ta përfundojmë projektin.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Ibrahim Selmanaj, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

IBRAHIM SELMANAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Unë do ta lexoj pyetjen për Kryeministrin, duke pasur parasysh se kohë më parë, në mediat e shkruara dhe elektronike, zoti kryeministër, është raportuar se kryeministri i

Kosovës ndërton një shtëpi me bazë 2000 m² në Prishtinë në një zonë të pa urbanizuar dhe parallogaria sjellë vlerën 3 milionë euro. Pyetja është: a janë të vërteta raportimet e mediave, a nuk janë të vërteta?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar Selmanaj, Në gjithë jetën time ka qenë parim transparenca para të gjithë qytetarëve dhe institucioneve. Pyetja e juaj e porositur, natyrisht se do ta marrë përgjigjen shumë të drejtpërdrejtë.

Në gjithë jetën time, e theksoj edhe një herë, çdo angazhim të cilin e kam bërë, e kam bërë për interes të vendit dhe të gjithë qytetarëve. Edhe kur e kam filluar projektin e çlirimit të vendit, me themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të gjitha të mirat e Zotit i kam pasur, por më ka munguar vetëm liria e vendit dhe qytetarëve të mi, dhe ato të mira kanë qenë si rezultat i djersës dhe mundit dhe solidaritetit familjar dhe sot e falënderoj familjen për mundësitë që mi kanë krijuar që t'i përkushtohem gjithë jetën time përkushtimit për liri, pavarësi dhe shtet ndërtim.

Në qershor të vitit 2008, me kërkesën e organeve kompetente të sigurisë të Republikës së Kosovës, kam qenë i detyruar të ndërroj vendbanimin nga Dragodani, ku e kam shitur shtëpinë. Duke mos dashur në asnjë rrethanë ta ngarkoj buxhetin e Republikës së Kosovës, tash e dy vjet unë jetoj në një banesë me qira tredhomëshe së bashku me familjen time, në katin e 7-të, adresa Bregu i Diellit, rruga "Hilmi Rakovica" numër 36, të përmendi në katin e shtatë, herë me ashensor e në shumicën e rasteve, pa ashensor. Për shkak të mundësive minimale për jetë, punë, por edhe siguri, gjithashtu, zoti Selmani, ju informoj se duhet të mundohem të kaloj në një banesë tjetër po ashtu me qira dhe po ashtu nga mjetet e mia të siguruara nga puna ime dhe e familjes sime.

E di se po pyetni apo po merreni shpesh edhe publikisht edhe për shkollimin e djalit tim. Djali im quhet Endrit, tash i mbush 11 vjet. Ditëlindjen e ka më 13 prill, është në klasën V. Edhe notat mund t'i verifikoni në shkollë. Është në shkollën "Mehmet Akif". Por, i nderuar deputet, ju kisha ftuar që të bëni pyetje për kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të mos merreni me familjet, të mos merreni me fëmijë.

Të dhënat complete dhe të sakta lidhur me pasurinë time dhe fillimin e ndërtimit të shtëpisë janë në dispozicionin tuaj dhe të gjithë qytetarëve dhe autoriteteve kompetente që kanë interes tek organet kompetente në komunën e Prishtinës, për më tepër, të gjitha të dhënat për pasurinë time, duke përfshirë edhe fillimin e ndërtimit të shtëpisë tash e dy vjet, janë deklaruar në agjencinë përkatëse dhe këto të dhëna do të bëhen publike shumë shpejt nga Aagjencioni. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti kryeministër!
Dëshironi pyetje shtesë deputet? Zotit Selmanaj fjalën!

IBRAHIM SELMANAJ: Realisht, kryeministër, shumë isha i interesuar për hir të transparencës dhe e besoj transparençën. E vërteta është se unë nuk marrë porosi prej kurrkujt. Në projektin e çlirimit të Kosovës, e din shumë mirë se nuk kam qenë përtej,

por kam qenë këtu. Unë të kam pyetur për shtëpi, e gëzofësh, e trashëgofsh edhe djali ishalla rritet. Do të jemi shumë të sigurtë, nuk ishte pyetje provokative, nuk ishte pyetje e rëndë dhe e dimë pasurinë e secilit, po sovrani, qytetari dëshiron ta dijë, ta dijë se po jeton në kushte të vështira. Kryeministri i vendit duhet të jetojë mirë dhe duhet të ketë shtëpinë, adresë ku secili do t'ia merr lakmi, sepse është kryeministër i vendit dhe ka përgjegjësi, për hir të përgjegjësisë, atëherë unë pyetjen e parashtrova fare thjesht.

Bëhu transparent para qytetarit të Kosovës, sepse nëse duhet t'iu besojmë mediave...

KRYESUESI: Zoti kryeministër, a dëshironi ta merrni fjalën?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë, me shpifje politike, të motivuara politikisht, me të pavërteta të prezantuara me motive politike, nuk mund të merrem, por është një dezinformim dhe është e pavërtetë. Të gjitha të dhënat mund t'i merrni në komunën e Prishtinës, që është një truall 15 ari dhe jo 3 hektarë, se unë nuk ndërtoj as kulla me një hapësirë trehektarësh, por dua të them se edhe unë një ditë do të jetojë si të gjithë ju në një shtëpi, edhe unë, edhe djali do ta vazhdojë shkollimin dhe nuk do të jetojë as në kullë, as në stan. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

GJYLNAZE SYLA: Thashë, mos ka edhe ministri farë shpie, por po kaloj në çështjen që ia kam shtruar.

Në ligjin nr. 03-L1-77 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, në kategorinë e projekteve kapitale është paraparë ndërtimi i objektit të shkollës së mesme "Prenk Jakova". (Nuk ishte pyetja për ju, zoti kryeministër) në Prishtinë, si projekt në vazhdim nga viti 2009. Shuma e ndarë për ndërtimin e shkollës është 400.000 euro. Jemi në muajin mars të vitit 2010 dhe ndërtimi i shkollës nuk ka filluar ende. Pyes ministrin Enver Hoxhaj, pse nuk ka filluar ndërtimi i shkollës së muzikës dhe kur do të fillojë ndërtimi i saj? Keni parasysh se ky është projekt i vitit 2009. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryesues,

I nderuar zoti Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë ministra,

Të respektuar deputetë,

Ndër problemet më të mëdha që i kemi me hapësirën shkollore është zakonisht, u referohen zakonisht qyteteve. Qyteti i Prishtinës këto 10 vjetët e fundit ka problem shumë të sigurojë vende se ku ndërtohen shkolla, edhe shkolla "Prenk Jakova", të cilën unë e kam vizituar në vitin 2008 një herë, në 2009, një herë, ka qenë e pamundur të fillojë projekti në ndërtimin e kësaj shkolle, meqë komuna e Prishtinës fillimisht ka

menduar që do të duhej të ndërtohet në vendin ku është shkolla aktualisht dhe aty realisht nuk ka hapësirë të nevojshme që të ndërtohet një objekt i ri, ku është objekti i vjetër dhe së dyti, komuna e Prishtinës, ka vendosur që kjo shkollë të ndërtohet afër fshatit Sos- Kinderdorf, mirëpo vendi ku është dedikuar, është një hapësirë ku është hedhur dhe, bërlllok dhe matjet e tokës flasin për atë, që në këtë hapësirë është pothuaj se e pamundur të fillojë ndërtimi i objektit të ri, meqë lëvizjet e tokës do ta dëmtonin në të ardhmen objektin, ndërsa ndërtimi i objektit në këtë vend, do të kushtonte dy-trefish se sa do të kushtonte në një vend tjetër.

Ne jemi në kontakt permanent me komunën e Prishtinës dhe në atë moment kur komuna e Prishtinës ta sigurojë një vend të përshtatshëm, do të fillojë edhe ndërtimi i kësaj shkolle e cila është shkollë e vetme e muzikës në kryeqytet dhe unë jam vetëdijshëm se shumë qytetarë të Prishtinës, kanë interes që t'i dërgojnë fëmijët në këtë shkollë të muzikës, qoftë me orar të plotë, qoftë edhe me orar si lëndë zgjedhore.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Dëshironi pyetje shtesë?
E ka fjalën Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ministër, merreni buxhetin, është tabela, tabela, 3.2. thotë - 400.000 euro, projekt në vazhdim nga 2009, ku janë 400.000 euro dhe a mundeni t'ju tregoni arsimtarëve se kur do të fillojë ndërtimi i shkollës së tyre, duke marrë parasysh se e paskeni vizituar në vitin 2009. Ju propozoj ta vizitoni sivjet, shihni se arsimtarët punojnë nëpër baraka, instalimi është vjetruar dhe mund të ngjajë deri te rrënim i asaj ndërtese e mos të flas për atë se është institucion edukativ dhe artistik shumë i rëndësishëm për kulturën tonë, megjithëse si ministër më tepër ishte dashur të merreshit me kualitetin e mësimi.

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Zonja deputete, unë edhe në këtë javë kam pasur takim me përfaqësuesit dhe me menaxhmentin e shkollës. Jam i vetëdijshëm që shkollat e muzikës në Republikën e Kosovës, kanë nevojë edhe për mbështetje, për atë ne kemi ndërtuar një objekt shumë të bukur shkollor në Gjakovë. Mendojmë që duhet të ketë objekte të tilla edhe në Mitrovicë, Pejë edhe në Gjiilan, në qytetet të cilat janë zona më të mëdha urbane, e po më duhet t'ju them që përderisa ne nuk kemi truallin të ndarë, realisht nuk mundem ta ndërtojmë këtë objekt shkollor, vetëm nëse ju dëshiron që ky objekt shkollor të jetë virtual, mirëpo realisht për pa pasur truallin, tokë, është e pamundur që të ndërtohet, prandaj edhe bartja e mjeteve ka ndodhur nga viti 2008 në vitin 2009 dhe nga viti 2009 në vitin 2008 për shkak të mungesës së hapësirës së vendit ku do të duhej të ndërtohej shkolla. Unë mendoj që çdo qytetar që jeton në Prishtinë, por edhe ata që herë pas herë e vizitojnë Prishtinën, e dinë që hapësira në Prishtinë është një shqetësim i madh, ma merr mendja që janë fakte konkrete.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!
Konstatoj se koha për pyetje është ezauruar, sipas Rregullores. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i tretë i Projektligjit për masat antidamping

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me vendimin e Kuvendit të datës 18 dhjetor 2009, ka rishqyrtuar amendamentet e propozuara në Projektligjin për masat Antidamping dhe Kuvendit i ka parashtruar raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, nuk dëshiron ta marrë fjalën. Kryetarët e grupeve parlamentare nuk e di, nuk është paraqitur askush që ta marrë fjalën, dhe po mendoj që të vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni funksional, sipas radhës së paraqitur në raport.

Atëherë, po vazhdojmë votimin veç e veç.

Amendamenti 1

Votojmë, tash.

Konstatoj që me 35 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër” kaq ka këtu vota, miratohet amendamenti, por nuk jam i sigurt... nuk ka kuorum për të votuar.

(Pushim 10 minuta)

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Ju lutem, deputetë, zini vendet!

Të nderuar deputetë, po fillojmë me votimet. Në sallë janë 61 deputetë, gjë që kemi kushte për të filluar votimin

Amendamenti 1

Votojmë, tash.

Ju faleminderit!

Me 51 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë, tash.

Me 52 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë, tash.

Me 56 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 4

Votojmë, tash.

Me 57 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë, tash.

Me 53 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”. Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë, tash.

Me 55 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë, tash.

Me 61 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 7

Amendamenti 8

Votojmë, tash.

Me 63 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë, tash.

Me 60 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë, tash.

Me 65 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë, tash.

Me 54 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë, tash.

Me 52 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë, tash.

Me 56 vota “për”, 3 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë, tash.

Me 63 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë, tash.

Me 65 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë, tash.

Me 56 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë, tash.

Me 64 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22

Votojmë, tash.

Me 58 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 22

Amendamenti 23

Votojmë, tash.

Me 60 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24

Votojmë, tash.

Me 66 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25

Votojmë, tash.

Me 58 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Votojmë, tash.

Me 61 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27

Votojmë, tash.

Me 57 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28

Votojmë, tash.

Me 55 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29

Votojmë, tash.

Me 54 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30

Votojmë, tash.

Me 61 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33

Votojmë, tash.

Me 60 vota “për”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34

Votojmë, tash.

Me 60 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35

Votojmë, tash.

Me 58 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36

Votojmë, tash.

Me 63 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37

Votojmë, tash.

Me 57 vota “për”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38

Votojmë, tash.

Me 55 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39

Votojmë, tash.

Me 56 vota “për”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40

Votojmë, tash.

Me 61 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41

Votojmë, tash.

Me 65 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 42.

Amendamenti 43

Votojmë, tash.

Me 63 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 43.

Amendamenti 44

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 44.

Amendamenti 45

Votojmë, tash.

Me 57 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 45.

Amendamenti 46

Votojmë, tash.

Me 60 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 46.

Amendamenti 47

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 47.

Amendamenti 48

Votojmë, tash.

Me 60 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 48.

Amendamenti 49

Votojmë, tash.

Me 68 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 49.

Amendamenti 50

Votojmë, tash.

Me 63 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 50.

Amendamenti 51

Votojmë, tash.

Me 60 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 51.

Amendamenti 52

Votojmë, tash.

Me 61 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 52.

Amendamenti 53

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 53.

Amendamenti 54

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 54.

Amendamenti 55

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 55.

Amendamenti 56

Votojmë, tash.

Me 52 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 56

Amendamenti 57

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 57.

Amendamenti 58

Votojmë, tash.

Me 56 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 58.

Amendamenti 59

Votojmë, tash.

Me 64 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 59.

Amendamenti 60

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 60.

Amendamenti 61

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 61.

Amendamenti 62

Votojmë, tash.

Me 61 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 62.

Amendamenti 63

Votojmë, tash.

Me 63 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 63.

Amendamenti 64

Votojmë, tash.

Me 66 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 64.

Amendamenti 65

Votojmë, tash.

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 65.

Amendamenti 66

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, 2 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 66.

Amendamenti i fundit nr. 67

Votojmë, tash.

Me 63 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 67.

Konstatoj që në sallë janë 77 deputetë. Tani të nderuar deputetë, votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Votojmë, tani.

Me 68 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, konstatoj që Kuvendi miratoi Ligjin për masat antidamping dhe masat kundër balancuese. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës.**

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar propozim vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Propozim vendimi i Qeverisë dhe raporti me rekomandimet e Komisionit funksional iu është shpërndarë deputetëve.

Tash sipas radhës, ia japim fjalën përfaqësuesit të Qeverisë, si propozues i çështjes që ta arsyetojë propozimin në fjalë. Ju faleminderit!

E ka fjalën, ministri i Transportit dhe i Postë -Telekomunikacionit, zoti Fatmir Limaj.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kolegë deputetë,

Ministra,

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, është një institucion që derivon nga Ligji për hekurudhat e Kosovës dhe obligon institucionet, përkatësisht Ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, që të themelojë këtë autoritet, i cili është i domosdoshëm dhe është praktikë standarde e zhvillimit të sistemit dhe tregut të transportit hekurudhor të Kosovës.

Për të qenë me standardet e kërkuara të Bashkimit Evropian, e shfrytëzoj rastin që të falënderojmë Komisionin Evropian i cili është pjesës e pandashme e transformimit të hekurudhave të Republikës së Kosovës, proces i cili përfundimisht do të shkojë drejt standardizimit të hekurudhave të vendit tonë me ato që sot janë në Bashkimin Evropian. Prandaj, siç parashihet nga Ligji për hekurudhat e Kosovës, Qeveria e Kosovës ka propozuar tashmë kandidatët për t'i emëruar në Bordin e Autoritetit të Hekurudhave të Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës, duke u mbështetur në kriteret ligjore profesionale dhe përvojën e mjaftueshme të kandidatëve për menaxhim, ka propozuar kandidatët, si më poshtë:

1. Halit Gara,
2. Gëzim Qerimi dhe
3. Ilmi Ahmeti

Duke marrë për bazë CV-itë e kandidatëve, si dhe planifikimin e trajnimeve dhe mbështetjen sistematike të Komisionit Evropian në Kosovë, në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës vlerësojmë që ARH-ja do të funksionalizohet dhe do të kontribuojë në rregullimin e tregut të transportit hekurudhor, liberalizimin e tij dhe integrimin regional e evropian.

Duke qenë të vetëdijshëm se transporti hekurudhor dhe vetë hekurudhat e Kosovës janë në nivel jo të kënaqshëm të zhvillimit, konsiderojmë se themelimi i ARH-së dhe emërimi i Bordit të AHR-së është i domosdoshëm për ta ndryshuar këtë trend. Është edhe si obligim ligjor dhe si kërkesë, siç thashë edhe më herët, e dalë nga raportet e Komisionit Evropian.

Bordi i ARH-së do të kryejë me kompetencë të plotë detyrat dhe përgjegjësitë sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin dhe

liberalizimin e tregut të transportit hekurudhor, si licencimin e operatorëve të transportit hekurudhor dhe lëshimin e certifikatave të sigurisë së operatorëve dhe krijimit të kushteve dhe rregullave që do të rezultojnë me një ambient të sigurt në aspektin ekonomik dhe atraktiv për investimet e huaja në këtë sektor.

Qeveria e Republikës së Kosovës deri më tash ka kryer një detyrë shumë të rëndësishme, e cila përfundimisht transformon këtë sektor tepër të rëndësishëm të transportit. Ka qenë një detyrë shumë e rëndësishme që del nga Ligji për Hekurudhat e Kosovës, sepse ka vendosur për ndarjen e hekurudhave të Kosovës në dy ndërmarrje publike: në atë të operimeve Tainkos dhe të transfrustrukturës Infrakos, të cilat po ashtu shërbejnë si bazë solide për përmirësimin e shërbimeve dhe të infrastrukturës së Transportit Hekurudhor të Kosovës. Prandaj, duke marrë për bazë se Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës e kanë obligim ligjor emërimin e këtij bordi të AHR-së, kërkojmë që edhe Kuvendi i Kosovës ta miratojë emërimin e anëtarëve të këtij bordi të rëndësishëm, duke marrë për bazë gjithmonë që ne po ndërtojmë një autoritet për herë të parë në vendin tonë me detyra të reja të cilat s'i kanë pasur përpara dhe, normalisht, do t'iu jepet mundësi këtyre njerëzve që përmes trajnimeve të Komisionit Evropian, të cilët po e financojnë këtë projekt, të trajnohen, të përgatiten edhe më tepër për të menaxhuar dhe, përfundimisht, edhe këtë sektor të rëndësishëm të transportit në Kosovë ta modernizojmë dhe ta bëjmë pjesë integrale të transportit hekurudhor në regjion e më tej në Evropë. Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj që sot ta votoni emërimin e këtij bordi, që pastaj të fillojë funksionalizimi dhe transformimi edhe në këtë sektor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Sipas radhës, fjalën e ka kryetarja e komisionit funksional, Myzejene Selmani, apo raportuesi i komisionit.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion në pajtim me Rregullën 41 të Rregullores së Punës të Kuvendit, përfundimin e Kryesisë së Punës të Republikës së Kosovës, me datën 19.02.2010, dhe të nenit 7 të Ligjit për hekurudha në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2010, shqyrtoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Numër 03/32572050, të datës 18.02.2010 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave në Republikën e Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim:

- I rekomandohet Kuvendit që të mos miratojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, datë 18.02.2010, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave në Republikën e Kosovës;

- Të kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të propozojë kandidatë të tjerë për anëtarë të Bordit të Autoritetit të Hekurudhave të Kosovës nga se të kandiduarit nuk i plotësojnë kushtet e parapara me Ligjin për hekurudhat në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m:

Komisioni gjatë shqyrtimit të propozimit të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërim të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave në Republikën e Kosovës vlerësoi se kandidatët e propozuar nuk i plotësojnë kushtet e nenit 7.2 të Ligjit të hekurudhave të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë edhe me datën 24.11.2009, e shqyrtoi këtë propozim-vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ka kërkuar që të propozohen kandidatë tjerë, sepse të njëjtit nuk i përmbushin kushtet ligjore.

Qeveria e Republikës së Kosovës prapë i ka sjellë kandidatët e njëjtë.
Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Sipas radhës, shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike... Kush e do fjalën? Salë Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Ne kemi një vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës për anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës që i ka propozuar Kuvendit të Kosovës për këta kandidatë. Po i përmendi edhe një herë emrat:

1. Halit Gara,
2. Gëzim Qerimi, dhe
3. Ilmi Ahmeti.

Ne si komision parlamentar e kemi shqyrtuar këtë vendim të Qeverisë, i kemi analizuar edhe CV-itë e tyre. Në bazë të CV-ve që i kemi këtu në material, del se ne e dimë gati për secilin kandidat që CV-ia e tyre është edhe më e pasur se sa kjo që na është paraqitur ne si deputetë, andaj dilemat kanë qenë te një pjesë e komisionit parlamentar se nuk i plotësojnë kushtet, po unë ndaj mendimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës se kandidatët në fjalë i plotësojnë në përgjithësi kushtet që të jenë anëtarë të këtij bordi. Ne jemi para dy detyrave shumë të rëndësishme, detyrës si obligim ligjor që duhet të kompletohen bordet dhe një detyre shumë të rëndësishme që duhet ta marrim shumë seriozisht kërkesën nga Raporti i progresit evropian që të plotësohen bordet në fjalë.

Unë edhe në komisionin parlamentar e kam përcjellë mendimin tim, që e mbroj edhe këtu, shumë të fuqishëm, sepse ne nuk duhet të bëhemi të ngurtë në bazë të ndonjë neni që mund të jetë edhe përjashtues në kësi raste, duke ditur faktin se në Kosovë nuk kemi profil të caktuar që studion hekurudhat, prandaj ne që të jemi në nivel dhe në përgjegjësi të kërkesës nga Raporti i progresit evropian, duhet ta miratojmë këtë propozim të Qeverisë.

Unë po e marr vetëm një shembull dhe po i përcjell polemikat që i kemi pasur në komisionin parlamentar. Nuk duhet të jetë automatikisht anëtar i bordit të aeroportit ai që

edhe e drejton avionin, në këtë rast pilotët. Prandaj, nuk duhet të nisemi nga një logjikë ngurtësie që të jemi pengesë e mosplotësimit të kriterëve që dalin nga progresi evropian, kështu që edhe në komisionin parlamentar votimi ka qenë 3 me 3, prandaj udhëheqësja e komisionit ia rekomanduar këtë rekomandim seancës, por unë kërkoj nga ju të pranishëm, të nderuar deputetë, që ta miratoni këtë propozim të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike? Zef Morina, e ka fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, kryeministër, ministra, të gjithë deputetët!

Deri në shpalljen e pavarësisë, hekurudhat janë menaxhuar dhe administruar nga UNMIK-u. Të gjithë e dimë në çfarë gjendje janë. Natyrisht që tash kjo është kompetencë e Qeverisë dhe unë mendoj që ky bord është pak i vonuar dhe është dashur më shpejt të miratohet.

Është shumë e vërtetë që gjendja në hekurudhat e Kosovës nuk është e kënaqshme dhe duhet në njëfarë mënyre këtu të merren masa shumë shpejt, qoftë nga Qeveria, nga Ministria, në këtë rast edhe bordi i cili duhet ta administrojë këtë. Është shumë e vërtetë që në komision është votuar, por kemi qenë 3 me 3, meqenëse vota e kryetares numërohet 2 herë, domethënë në njëfarë mënyre kemi qenë 50 me 50. Unë mendoj që ne patjetër duhet ta pranojmë këtë rekomandim të Qeverisë, sepse kandidatët nuk është se nuk i plotësojnë kriteret, plotësisht i plotësojnë, por nuk e di a ka në Kosovë njeri që është apolitik, e neni i Kushtetutës ose i ligjit thotë se s'duhet të jetë në politikë, ne të gjithë jemi në politikë. Nëse nisemi nga kjo, atëherë asnjëri nuk ka mundësi të jetë anëtar i Bordit. Andaj, unë si përfaqësues edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së them që LDK-ja i pranon këta anëtarë të Bordit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Realisht, është tepër e qartë se kur voton Kuvendi, tanimë është bërë praktikë që ata që votohen, të jenë politikë. Edhe nëse ka provizione ligjore të cilat kërkojnë diçka ndryshe dhe, hajt se po e pranojmë, do të thotë, meqenëse shumica në Kuvend duhet të votojnë, shumica i lyp njerëzit e vet dhe i voton, por po llogarisim se njëfarë parimi, në rregull, po pajtohem që të jenë politikë, të jenë anëtarë të partisë, aktivistë të devotshëm, ish-deputetë, çka do qoftë. Ama, seriozisht, ne kemi shpresuar që një kohë të gjatë, besoj edhe populli i Kosovës ka shpresuar që prej atyre politikë të paktën të gjenden disa njerëz që i plotësojnë kriteret ligjore. Do të thotë, nëse nuk po plotësohet ai kriter që të jenë të paanshëm ose çka do qoftë, atëherë të paktën minimumi, do të thotë, diçka si nominalisht të kemi njerëz të cilët janë ose të Partisë Demokratike të Kosovës ose të Lidhjes Demokratike të Kosovës, krejt në rregull, por të paktën t'i plotësojnë kushtet ligjore. Domethënë, nëse nuk keni asi njerëzish, atëherë nuk është keq të gjenden prej shoqërisë civile, ndoshta edhe ndokush prej opozitës pranon të vijë, ama të paktën ligji të respektohet për shkak se po shkaktojmë situata tepër të këqija në Kosovë, po çelim

shtigje të cilat nuk i ndihmojnë vendit, qysh po shihet, në çfarë gjendje e kemi vendin. Tash janë disa pyetje këtu.

Unë kisha dashur, për hir të argumentit, ta lexoj nenin 7.2, i cili thotë:

a) Anëtarët e Bordit duhet të kenë diplomë universitare apo kualifikim profesional ose teknik përkatës, do të thotë, përkatës.

b) thotë, së paku 3 vjet përvojë në sektorin hekurudhor në Kosovë apo në fusha tjera përkatëse dhe

c) Njohuri për kërkesat mbi sigurinë në hekurudhat.

Ky është ligj të cilin e ka sjellë Ministria e Transportit në Kuvend të Kosovës dhe është aprovuar në Kuvend të Kosovës.

Tani po e bëj një përmbledhje më pak se një minutë, se çfarë kualifikime kanë këta zotërinjtë që mund të jenë të respektuar në fusha të veta.

Gëzim Qerimi, është i diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike dhe të Administratës Publike. Vazhdon studimet master në Fakultetin Filologjik – drejtimi në media dhe marrëdhënie me publikun. Përvoja në punë, thotë se ka përvojë në Senatin e Universitetit të Prishtinës.

Halit Gara, sipas të dhënave që i ka paraqitur vetë, e dikush prej deputetëve tha këtu që nuk i kanë paraqitur krejt, nuk është faji ynë nëse s'i kanë paraqitur krejt, thotë: është ekonomist i diplomuar në banka dhe financa. Vijon studimet master në Kolegjin FAMA – drejtimi në menaxhment dhe informatikë. Ai ka punuar në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Krejt në rregull.

Ilmi Ahmeti, në bazë të CV-së që e ka dorëzuar, e ka kryer Fakultetin Xehtaro – Metalurgjik - Dega e Gjeologjisë, në Mitrovicë. Ka punuar si profesor në shkollën e mesme teknike “Trepça”.

Tani, nëse dikush mendon që këto profesione që i përmenda unë saktë qysh i kanë shkruar, kanë të bëjnë me sigurinë në hekurudha ose që kanë punuar rreth hekurudhave qysh lyp ligji, saktë, do me thënë është e shkruar në ligj, nuk po shpiki kurrgjë unë, atëherë Kuvendi le të na thotë neve që dikush prej nesh e ka gabim, nuk po kupton. Unë po them edhe një herë, citova, e lexova ligjin dhe e lexova një përmbledhje të asaj që e kanë sjellë kandidatët që po i propozon Qeveria, si CV.

Mendoj se edhe një çështje tjetër na mungon neve si deputetë. Në materialin që e kemi marrë është bashkëngjitur një letër nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian, nga zoti Jonson, që ia ka drejtuar ministrit Limaj. Letër krejt në rregull, letër që kërkon t'i përmbush obligimet ligjore Ministria në mënyrë që mos të ndërpritet financimi i projekteve përmes të cilave na ndihmon Unioni Evropian përmes Zyrës së Komisionit në

Kosovë. Nëse na vjen një pjesë e korrespondencës, atëherë ka qenë dashur të kemi edhe pjesën tjetër të korrespondencës për shkak se është një kulturë institucionale ose e qeverisjes së mirë, që po e përmendim krejt kohën, që të paktën të ketë një rrjedhë të asaj se çka po ndodh. Do me thënë, nëse neve na sillen këtu si material letra e dikujt që ia ka drejtuar një ministri të Qeverisë së Kosovës, ka qenë në rregull ta kemi edhe një letër nëse ia ka kthyer ministri zotit Jonson, me shpjegimet e tij. Përndryshe, nëse vetëm njëra letër vjen te ne, atëherë neve na krijohet përshtypja se dikush na e ka sjellë këtë letër për të na thënë që më mirë votoni, se bëni s'ë votuat, kuku çka na gjet neve. Realisht, mund të them që një mori e elementeve që i gjejmë ne tani këtu, janë elemente që nuk na bëjnë të ndihemi mirë si deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe sot është një prilli, nuk po e përmendi atë fjalën se e ka shumë mërzë kryetari, më ka lutur një herë ta lëshoj sallën, por është ajo farë dite – një prilli, e asaj s'po ia përmendi fjalën, por jeni duke ditur të gjithë çka po mendoj – mos bëni kështu me ne. Mos bëni kështu dhe mos na thoni nuk i kanë shkruar krejt, mos na thoni i plotësojnë krejt kushtet, tregoni se po doni të votohen dhe mos na humbni kohë, si Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AKR-së fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryetar!

Nuk është hera e parë që Qeveria sjell propozime për emërimin e anëtarëve të bordeve që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe do t'i preferoja Qeverisë së tashme të riformatizuar që së pari të ndërmarre veprimet për ta ndryshuar ligjin dhe pastaj të sjellë në Kuvend propozime të cilat do të jenë në pajtim me ligjet në fuqi. Kandidatët nuk i plotësojnë kriteret e parapara me ligj. Ndoshta kanë përvojë në hekurudha, sepse dikujt mund t'i kalojë hekurudha afër shtëpisë ose afër shkollës, por kandidatët të cilët janë këtu të propozuar nuk i plotësojnë kriteret e parapara me ligj. Dikujt mund t'i kalojë hekurudha afër, s'është problem, nëse e merrni si përvojë atë!

Së dyti, që është shumë me rëndësi sepse nuk është hera e parë, nuk është hera e parë që këtij Kuvendi... po, është për të bërë hajgare, seriozisht, sepse po bëni hajgare me Kuvendin. Nuk është hera e parë që këtij Kuvendi i sillen po të njëjtat propozime të cilat Kuvendi i kthen një herë prapa, sepse janë përpjekje të vazhdueshme që Qeveria t'i sjellë në krye të këtyre bordeve njerëzit e vet dhe këto borde janë më së paku të pavarura, prandaj do të ishte mirë të hyhet në ndryshimin e ligjit dhe të bëhen bordet të varura nga Qeveria, sepse do ta kishim edhe ne më lehtë.

Nëse komisioni, pra, ka vërtetuar me datën 3.7.2009, më 24. 11.2009 se propozimet nuk i plotësojnë kriteret e parapara me ligj, atëherë si ndodhi që po të njëjtat propozime, të cilat janë refuzuar një herë tashmë, të jenë në pajtim me ligjin. Po kërkoj edhe prej komisionit që të mos veprojë kështu, sepse ne kemi edhe propozime tjera, të cilat një herë i plotësojnë kushtet, pastaj nuk i plotësojnë, ose e kundërta. Po njëjtë e keni edhe tashmë, që Qeveria i ka sjellë në Kuvend për drejtorin për Zyrën Rregullative për Ujë dhe Mbeteurina dhe zëvendësdrejtorin. Dy kandidatë të cilët ky Kuvend, kështu si është, i ka refuzuar në një seancë plenare. Po i përmendi këto, kryetar, me një qëllim, që të mos na sjellin propozime me emra të cilët një herë Kuvendi i ka refuzuar, sepse nuk është as praktikë e mirë kjo. Faleminderit!

KRYETARI: Në fakt, Kuvendi nuk i ka refuzuar, por ne si Kryesi pa drejtë i kemi kthyer prapa. Realisht, Kuvendi nuk i ka kthyer. Do të thotë, të jemi korrektë. Vazhdojmë. Në emër të LDD-së kush e kërkon fjalën? Deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministra, deputetë të nderuar,

Edhe Lidhja Demokratike e Dardanisë është në mbështetje të rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për mos miratimin e propozimit të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kandidatëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave në Republikën e Kosovës, ngase nuk i plotësojnë kushtet e parapara me Ligjin mbi hekurudhat e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Mi çemo i ovoga puta podržati ovu listu, ali postavljam pitanje, pošto je tu i premijer Vlade – kada će jednom biti neki kandidat iz nevećinske zajednice koji će biti u nekom bordu. Zaista mislim da zakonom to nije bilo predviđeno. Zakoni koji su prošli po ubrzanoj proceduri iz Ahtisarijevog paketa imaju nekoliko nedostataka jer nisu dati neki mehanizmi za zaštitu zajednica, drugih zajednica i često puta to dobijamo – evo nekoliko predloga za nekoliko bordova, za nekoliko komisija gde nikada ne bude neki od članova iz drugih zajednica. Zaista mislim da je krajnje vreme da se i oko toga povede računa i da dobijamo, sa ovim predlozima da bude i kandidata iz drugih zajednica. Možda manjine nemaju železničare i te stvari, ali imaju druge ljude gde mogu da budu u bordovima. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Petar Miletij e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala! Poslanici Parlamentarne grupe Samostalne liberalne stranke podržaće za članove Regulatornog borda kosovskih železnica upravo ove kandidate. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputeti Numan Baliq e ka kërkuar fjalën.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zotëri kryetar i Kuvendit!

U ime Parlamentarne grupe za integraciju želim istaći samo nekoliko kratkih napomena. Na jednoj strani, kada govorimo o železnicama Kosova, shvatamo da imamo potrebu, imajući u vidu u kakvom su stanju, da pospješimo razvoj tih železnica, a sa njime i imenovanje ovog borda i pomoći na bilo koji način rješavanje ovog važnog pitanja djela saobraćaja koji se obavlja na Kosovu.

Na drugoj strani, imamo takode neke činjenice koje se tiču samog odlučivanja vezano za bord koji je predložen i kandidata koji su predloženi. Simptomatično je da je u Komisiji bila jedna podvojenost i da je polovina članova funkcionalne komisije glasalo za kandidate, a da je polovina bila protiv. Mislim da bi bilo... da se ustali jedna praksa u funkcionalnim komisijama da se usaglase ili apsolutna većina ili jednoglasno podržava odgovarajuća lista i da jednostavno najpre funkcionalne komisije kandidate koje nude da se međusobno dogovore, a da se izbjegne ovakva dilema koja bi postojala pred samim poslanicima Parlamenta.

Na drugoj strani, dodao bih takode da je trebalo voditi računa i da treba voditi računa u buduće vezano za kandidate, za njihovu spremnost, obrazovanje, potom iskustvo u rukovođenju ovim poslovima ili menadžiranju, kako se to danas popularno kaže, a takode bi trebalo voditi računa oko toga da predstavnici svih zajednica budu uključeni ne samo u imenovanju i određivanju članova bordova, nego u razgovoru oko tih stvari, pripremanju kandidata, stvaranju tih lista koje su potrebne i izbora najboljih kandidata. Eto, to su neke principijelne preporuke koje bih htio dati i sa stanovištima naše Grupe, mi ćemo ostaviti na savjesti svakom poslaniku da glasa za predloženu listu ili ne. Ako bih osobno mogao reći ako će to pospješiti razvoj železnica i razvoj Kosova u opšte, osobno bih bio spreman da prihvatam ovu listu ali, naravno, svaki naš zastupnik će glasati prema svojoj savjesti. Hvala vam lepa!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Radha është e deputetëve. Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka. Përpikuni të jeni racional, deputetë që e keni fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar!

Sinqerisht, me qëllim që të jem racional në kuptimin e koncizitetit, të precizitetit, do t'i them vetëm dy nga shumë maksima të arta. Njëra është – *Res judicata*, tjetra është – *Dura lex sed lex*. Dhe, ju lutem, për *Res judicata*, një çështje, te shtetet moderne. Unë flas në favorin e ekzekutivit, që fiton edhe reputacion, edhe renome, edhe prestigj kur i përfill aktet ligjore, ato që i kemi – kjo është *Dura lex sed lex*. Në rastin konkret, nuk i plotësojnë kushtet e ligjit, ju lutem! Prandaj, nuk është fare mirë që të shkojmë kësisoj. Tek e fundit, më besoni, rastësisht i njoh dy persona që kanë studiuar në Zagreb, kanë kryer fakultetin katërvjeçar të hekurudhave dhe nuk janë partiak. Fundi i fundit, le të jenë partiakë, se siç e tha edhe zotëri Gjini, nuk duhet të jetë pengesë në jetën tonë. Unë vetë s'jam partiak, po nuk është kjo si të them... ju lutem! Nuk është, nuk duhet të merret pengesë, po le ta zhvesh petkun e partisë kur të jetë në funksion dhe kaq. Për mua, unë do të votoja për ata, mirëpo në rastin konkret, nuk i plotësojnë kushtet e ligjit. Ligjin e kemi, ta përfillim ligjin, se në atë mënyrë i japim kontribut edhe Qeverisë, edhe Parlamentit, edhe vetvetes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Naim Rustemi e ka fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk po mund të kuptoj si është e mundshme të sillet diçka në Kuvend që nuk jemi të qartë se a i plotëson kushtet formale dhe juridike.

Në rast se nuk plotësohen kushtet formale juridike, përpjekja të bëhet me votë, është përpjekje për manipulim, në rast se nuk i plotëson. Dhe, të kemi parasysh që edhe Qeveria mund të dalë në gjyq. Çka nëse nuk i plotësojnë kushtet dhe ata që s'kanë qenë në listë, nuk janë selektuar, e padisin në gjyq? Atëherë, ministri i ri i Drejtësisë do ta ketë problem ta mbrojë Qeverinë para gjyqit, sepse kërkesa për t'i ikur ligjit, kërkesa për të kaluar diçka që nuk i plotësohen kushtet, është kërkesë manipulante dhe është pak sa demagogjike. Kjo, në rast se nuk i plotësojnë. Po dikush këtu ka faj, se komisioni është gjysmë për gjysmë. Nuk bën njëra palë pa u ndëshkuar deri diku. Së paku edhe publikisht të thuhet – pse po thotë s'i plotëson, kur po i plotësuaka. Kjo është pak sa edhe demagogjike dhe kjo ma kujton diskutimin e deputetit Sabri Hamiti në njërën prej mbledhjeve të kaluara, që më ka sfiduar nga shpjegimi i deputetit për fjalën “demagog”. Dhe, duke pasur parasysh se shpjegimi i tij i pati tejkaluar kufijtë dhe zhbllokuar barrierat e ndërtuara në diskutimet në Kuvend, po e falënderoj për përpjekjet e tija që të sjellë sado pak etikë dhe moral në politikën e Kosovës.

Pra, tashti po e kthejmë edhe një herë fjalën demagogji në diskutim. Edhe ashtu është prezent në veprimet e politikanëve më të lartë të shtetit. Fjala demagogji do të thotë mashtrim i masave popullore, duke joshur me fjalë të bukura e me premtime të rreme për qëllime e synime të caktuara politike, qëndrimi i politikanëve me dy fytyra. Iu përshtatet për mrekulli të gjithë atyre që me qëllim nuk e respektojnë dokumentin më të lartë të vendit – Kushtetutën. Janë ata të cilët iu takojnë grupeve të interesit, që ata e dinë çfarë interesash kanë, që e terrorizojnë qytetarin e Kosovës me mosrespektim të Kushtetutës. Janë demagogët të cilët me fjalë të bukura e të zbrazëta kanë për qëllim të mbulojnë e të shtrembërojnë të vërtetën. Por këta, ke parasysh se mund të ndahen veç në dy grupe: në injorantë dhe të shantazhuar. Janë vetëm këto dy grupe, sepse të tjerët nuk ka mundësi që të arsyetojnë veprimet jokushtetuese. Nuk mundesh të thuash dje diçka, sot tjetër çka. Deri dje të shash, sot të lëvdosh. Ata janë njerëz me dy fytyra.

(Ndërhyrje, reagime)

Po, në temë jam! Në temë, pikërisht! Sepse të gjithë ata që nuk iu takojnë këtyre dy grupeve, nuk e lejojnë veten të jenë pjesë e matrapazllëqeve partiako-grupore. Edhe rasti i tashëm këtu, nuk është mirë të manipulohet Kuvendi, të sillen diçka që është kusht. Normalisht, është kusht formal dhe juridik. Njëjtë sikur që është respektimi i Kushtetutës nga Presidenti i Kosovës. Në rast se ai e thyen Kushtetutën, gjithçka çka të duash ministri mund të bëjë. Të bie edhe me shkollë fillore. Kaq.

KRYETARI: Deputeti Eqrem Kryeziu, ka kërkuar replikë!

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zotëri kryetar!

Më lejoni që si zakonisht t'ju kërkoj leje që t'i përshëndes zëvendëskryeministrin, ministrat, ministrat e ri, t'u uroj gjithashtu sukses. Dhe, më në fund, po shoh se gjërat po vinë në vendin e vet, sepse reagimi im ka qenë tri e ca javë më parë, pikërisht për këtë ndërhyrjen e zotëri Naim Rrustemit. Edhe unë pata për të thënë se me të vërtetë e ndjeja

veten shumë komod, madje me një kënaqësi apollonike kur u hap tema e leksikologjisë, çka do të thotë “demagog”.

Mirëpo, zotëri Naim Rrustemi besoj që u tregua pak më i guximshëm se sa që duhet. Faleminderit! S’kam më!

KRYETARI: Faleminderit! Mirë, një minutë, veç tani e kam një minutë edhe unë replikë me ty. Naim Rrustemi e ka fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Gjithmonë të flasim çka do që thotë. Kushtetuta është organi më i lartë. E kemi votuar këtu në Kuvend, duhet ta respektojmë. Kemi rrahur shuplakë. Meqenëse i kemi bërë të gjitha këto ceremoni, është gjynah mos ta respektojmë. Edhe nëse e bën si Apoloninë, ku kanë mbretëruar mbretërit, ku kanë sunduar mbretërit, atëherë normalisht, një vend - ministër, kryeministër, president e kryetar i katër partive, atëherë ti je mbret. Faleminderit!

KRYETARI: Naim, si deputet po të them, realisht kur Kosova kishte nevojë për njerëz me një fytyrë, ishin do me shumë fytyra që jetonin në metropolet e Evropës. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Pozdravljam predsednika Skupštine, Vladu i kolege poslanike. Nisam imala nameru da se javljam povodom ove tačke, ali uporno dobijamo od Vlade kandidate koje ovde čujemo da su jednom vraćeni, da je isto Komisija bila podeljena i moramo da kažemo da smo se zabrinuli, ja kao poslanica govorim u svoje ime, da sam pogledala CV svih kandidata koji su aplicirali za članove Borda železnice.

Ne bih htela da ponovim, ali sami dokumenti pokazuju da nijedan kandidat ne ispunjava uslove. Jedan od kandidata je, kao što smo čuli, ekonomista, drugi je završio filološki fakultet, treći isto završio rudarstvo a radi u prosveti. Znači, mi sa ovim ispred Evropske komisije pokazujemo praktično da nemamo kadrove, što nije tačno. Na Kosovu ima kadrova. Jedno. I drugo, mi treba da lobiramo kada su u pitanju ove komisije i bordovi sa pravim kadrovima i da dovodimo prave ljude na pravo mesto, da se o tome brinemo svi kako bi imali uspeha, a naročito u železnici koja je u zaostatku, kako bi integrisali našu železnicu sa regijom i sa Evropom.

Jedno što hoću da ukažem ovde, jeste da se malo ozbiljnije pozabavimo sa kandidatima i da kažemo – ako ne ispunjavaju uslove, da se krši Zakon o železnicama, stav 7. tačka 2. i ako smo mi ovde kao Skupština da kršimo zakon, to je u redu.

Drugo, kada su u pitanju bordovi, kada nisu prisutni članovi ostalih zajednica, ponovo apelujem da se to ne dešava kako bi bilo... To nam je prošlo, rekao je gospodin Idrizi, kroz ad-hoc zakone koje smo usvajali, bilo je u prošlom mandatu obaveza članova borda, ja opet kažem da to bude zbog integrisanja ostalih zajednica i dajem do znanja da u zajednici, kao što je Srpska zajednica, imamo jako velike stručnjake kada je u pitanju železnica, a to bi bilo pitanje povezano i sa integracijom ostalih zajednica i sa porukom

Evropskoj komisiji i Evropi da gradimo jednu zajedničku državu ovde na Kosovu. Mi smo više puta kao poslanici ovde razočarani i ja apelujem da se malo više Vlada bavi i da lobira sa pravim ljudima kada treba da budu članovi koji će voditi politiku železnica, koji će krojiti praktično budžet, koji će unaprediti železnicu. Ne može jedan filolog, filozof, ekonomista ili običan prosvetni radnik da unapredi železnicu. Toliko. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet Driton Tali, i fundit.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Përsëendetje për juve, ndërsa nënkryetarit Eqrem Kryeziut, përsëendetjeve të tij për kabinetin dhe urimit do t'i bashkëngjitem kur të legjitimohet ky kabinet qeveritar me votën e Parlamentit.

Sot komisioni funksional i ka ofruar Parlamentit dhe mendoj që nuk është hera e parë, por është mirë që të vazhdohet që Kryesia e Parlamentit të respektojë Rregulloren. Nëse nga komisioni parlamentar funksional kërkon një mendim dhe mendimi është i bazuar në fakte dhe argumente, të cilat u thanë këtu nga kryetarja e komisionit, është mendoj në nderin dhe respektin dhe autoritetin e Kryesisë së Parlamentit që ta respektojë. Në të kundërtën, nuk ka kuptim bashkëpunimi dhe puna në këtë relacion. Prandaj, mos ta vazhdojmë praktikën që të mos vejmë, pra, sundimin dhe respektimin e ligjit ose të kriterëve ligjore. Edhe një shkelje e madhe nga ajo që është brenda këtyre letrave, që megjithatë mendoj se duhet ta merrni për të mirë mendimin e komisionit, jo të kundërtën, sepse na bën nder të gjithëve, jo vetëm në këtë rast, por le të jetë një shembull që të fillojmë diçka të punojmë mirë, prandaj mos të vazhdojmë me thyerjen e këtyre kriterëve dhe të këtyre parimeve që i ka kodifikuar ligji. Nuk i plotësojnë kriteret me ligj, nuk janë njerëz profesionalë, nuk janë njerëz autoritet që mund të menaxhojnë me një bord kaq të rëndësishëm, si sektor, dhe le t'i mbetet tjetër propozuesit mendimi i tij qeveritar, që mendoj nuk e ka përmbushur këtë performancë që duhet, nuk i bën nder. Prandaj, mendimi im është që nuk duhet të votohet dhe duhet të respektohet mendimi i komisionit, që është plotësisht në pajtim me kriteret, parimet dhe ligjin. Prandaj, ju lutem, respektoni ligjin dhe Kushtetutën!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Driton Tali. Tani na u shtuan edhe tre diskutues...

DRITON TALI: Faleminderit!

Unë, t'ju them të drejtën, nuk desha ta marr fjalën, por më sfiduan dy kolegët e mi të nderuar, zoti Rrustemi, me të cilin nuk pajtohem me atë që e tha, dhe zotin Eqrem Kryeziu, që pjesërisht pajtohem me të, por edhe me disa deputetë tjerë që mendoj se po i mbesin në qafë Kuvendit me nevojë e pa nevojë.

Nuk është ndonjë mëkat i madh i Kuvendit të Kosovës që nganjëherë po na ikin gjërat jashtë Kushtetutës, po them, duke marrë parasysh atë, po them gjithmonë si dashamirë i madh që jam i presidentit, i Kryetarit të Kosovës. Ai na ka bërë yrnëk të asaj që Kushtetuta bën të respektohet, bën të mos respektohet. Po na vetë e kemi shkruar atë Kushtetutë, kur kemi qejf, e respektojmë, kur kemi qejf, s'e respektojmë. Po a jemi ne ata deputetë që e kemi votuar atë Kushtetutë? Edhe kryetari është njeriu i parë i Kosovës dhe

ai ka të drejtë të jetë kryetar i një partie tjetër, madje edhe i një partie tjetër, edhe kryetar të njëjtën kohë dhe unë s'po shoh të keqe këtu. Unë s'di çka i mbetet në krye ky deputeti, ky miku im këtu – kryetarit pa lidhje. Pse ai që e paska ngrirë njëherë pozitën, po ajo krejt normale është të ngrihet pozita, mund të jetë kryetar edhe i një partie tjetër. Tash po dëgjoj që edhe disa parti tjera donë t'i formojnë, mundet edhe atje ta ngrijë pozitën e kryetarit dhe vazhdojmë më tutje, nami s'u bë.

KRYETARI: Driton, kthehu në rend të ditës!

DRITON TALI: Në rend dite isha, se u kritikua Kuvendi, që s'po e respekton Kushtetutën dhe unë e mbroj, jam këmbëngulës ndaj asaj.

KRYETARI: Faleminderit, shumë!
Fjalën e ka deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Unë këtë listë nuk do ta mbështes dhe nuk do ta përkrah edhe nga një fakt tjetër, që deri më tash nuk u tha. Në këtë listë nuk ka asnjë emër të kandidateve femra. Ku na mbeti barazia gjinore në këtë rast? Ajo që vërtet deri më tani po flitet me të madhe dhe flitet se jemi duke e avancuar barazinë gjinore, në të kundërtën veprohet në Kuvend. Në asnjë listë dhe në asnjë bord, asnjëherë nuk shohim asnjë emër të femrës, qoftë edhe nga lista që sot është prurë në Kuvend, shihet që të tre kandidatët nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme për të qenë në vendin e duhur. Prandaj, në bazë të këtyre kriterëve që na kanë ardhur, ndoshta është dashur të jetë edhe një emër e kandidates femër dhe, thjeshtë, të përmbushet ai kriteri i barazisë gjinore, sepse kjo deri më tash po çalon. Kjo është një arsye e fortë që unë nuk do ta votoj këtë listë dhe nuk do ta mbështes.

KRYETARI: Deputeti i fundit i lajmëruar për diskutim është Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër, të nderuar ministra,

Unë pak edhe në frymën e datës, më lejoni që t'ju uroj punë të mbarë ministrave të rinj. Unë i dëgjova të gjitha vërejtjet që u dhanë për kandidatët e propozuar dhe më lejoni që të dalë në mbrojtje të tyre, së paku te ky i treti, që është i lindur në vitin 1961, ma merr mendja që e ka kryer ushtrinë dhe ka shkuar ushtar me tren dhe është kthyer në shtëpi dhe nuk mundeni, të nderuar deputetë, ta akuzoni që nuk ka përvojë me hekurudhat e Kosovës. Edhe le të dalë një deputet i Kuvendit të Kosovës që mund të thotë që shumë i nderuari Bleron Stavileci nuk ka përvojë në bujqësi, kur e ka parë lopën në çokollatat "Millka" dhe tash do të merret me ferma të lopëve, me zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë. Pra, të keni parasysh, të nderuar deputetë, se nuk mund të thoni që nuk kanë përvojë dhe nuk e njohin profesionin për të cilin Qeveria i emëron këta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Propozuesi e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, ministër Limaj!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuar kryetar!

Vërtet unë u përgatita pas fjalëve që u thanë dhe mendoj se kishte nevojë për të sqaruar, por në fund e pash se kjo u bë hajgare, kështu që nuk e vlen as të flitet. Me atë që e tha zoti Maloku, në fund, ia zuri majën, nuk e vlen as të diskutohet, me vetë faktin që tallemi me këtë mënyrë me njerëzit. Domethënë, dëshirojmë të tallemi pak se...

Njëri është ish kolegu juaj, deputet, që ka qenë dy mandate, njëri nga kandidatët. Dhe ju, secili në veti me u bë, e shihni veten me u bë president i këtij vendi, thoni bën, i plotësojmë të gjitha kushtet për të qenë president i Kosovës, secili prej neve. Më falni! Unë jam duke dhënë mendimin që legjislacioni, ky Kuvend i nderuar, në mënyrë jashtëzakonisht të mirë i ka paraparë me ligj mundësitë që i ka ky vend. Dhe, njëri nga nenet, që i përmendi shumë mirë zoti Gjini, në nenin 7.2 të Ligjit për hekurudhat thotë: “anëtar i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës duhet të ketë, a) diplomë universitare, apo kualifikim përkatës teknik”. Të tre kandidatët i kanë diplomat universitare. S’kanë kualifikim përkatës teknik. Ne jetojmë në këtë vend këtu, kemi shumë profesorë, duke filluar prej profesorit Rizë e shumë këtu të tjerë, themelues të Universitetit kemi këtu dhe e dimë që Kosova nuk ka pasur asnjëherë fakultet të hekurudhave. Dhe, ne nuk mund t’i shpikim njerëzit. Janë tre kandidatë, tre njerëz që kanë përvojë në begraundin e vet, kanë treguar aftësi menaxhuese në sektorët, në punët ku kanë punuar dhe sot po jepet mundësia që të tregojnë në bashkëpunim me trajnime, me përgatitje, me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar, miqve tanë profesionistë, që të vazhdojnë të menaxhojnë edhe në këtë fushë me kompetencat që i kanë me ligj. Prandaj, unë mendoj se nuk shkelet ligji. Ky nen tregon që nuk shkelet ligji. A i kanë përgatitjet komplet profesionale adekuate, këtu nuk ka asnjë dilemë që nuk i ka, po s’i ka as Kosova, s’kemi kuadër. Ndërsa, në anën tjetër, kur të kërkojmë të respektohet ligji, të nderuar deputetë, ta respektojmë deri në fund. Komisioni parlamentar nuk ka të drejtë me ligj ta kthejë një propozim të Qeverisë, por ka të drejtë Parlamenti. Parlamenti i Kosovës e kthen, sikur që është sot këtu, vota juaj do ta kthejë apo do ta miratojë. Edhe kjo është pjesë e ligjit dhe ta respektojmë ligjin.

Dhe, në fund, përsëri po them, ne jemi këtu njerëz të politikës, të profesioneve të ndryshme. Do të kisha kërkuar që të rezervohemi nga tendenca për të ofenduar njerëz, aq më tepër njerëzit e së ardhmes të këtij vendi, intelektualët e rinj të cilët sa ne, edhe ata kanë të drejtë të marrin përgjegjësi për ta drejtuar vendin e tyre.

KRYETARI: Mirë, fjalën e ka Naim Maloku, ia ke përmendur emrin.

NAIM MALOKU: Zoti ministër, faleminderit që ma përmende emrin.

Unë, sinjerisht kisha kërkuar falje prej të gjithë atyre, edhe prej Blerand Stavilecit, ministër i nderuar, në asnjë mënyrë nuk kam fyer, as nuk kam përdor fjalë për të fyer personalitetin ose profesionin për të cilin janë të aftë dhe kanë studiuar.

Zoti ministër, nuk është e vërtetë që Kosova nuk ka njerëz profesionistë që kanë kryer fakultetet – drejtimin e hekurudhave. Zoti profesor e tha që i njeh dy, unë njoh edhe më shumë dhe nuk është e vërtetë, zoti kryeministër, që Kosova nuk ka njerëz profesionistë që mund të udhëheqin në mënyrë profesionale Ministrinë e Bujqësisë, njerëz të aftë që

absolutisht nuk ka fyerje për asnjë person. Është vetëm që njerëzit e profesionit adekuat të emërohen në vende adekuate, të cilat mund t'i kryejnë në mënyrë profesionale. Vetëm kaq kam pasur. Edhe një herë po e përsëris, në qoftë se kushdo e ka ndier fjalën time, unë e thashë edhe në bazë të datës e send, fyerje ... Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, urdhëro! Fjalën e ka kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë kam theksuar edhe dje, dhe ritheksoj edhe sot – ndihem tepër i nderuar që kam punuar me ministrat përkatës, kabinetin qeveritar në dy vitet e kaluara dhe ai ekip është një ekip që ka bërë të arritura jashtëzakonisht të rëndësishme për vendin dhe këto të arritura i janë të njohura çdo qytetari të Republikës së Kosovës. Por, tek çështjet që gjithashtu u ngritën këtu, në fakt unë do të dëshiroja që të përgjigjem në dy pyetjet që u ngritën. E para, unë përsëri falënderoj të gjithë ministrat për punën e tyre të mirë, po me krijimin e rrethanave të reja, shtimin e përgjegjësive dhe të kërkesave natyrisht edhe të qytetarëve, por edhe të fuqizimit të vizionit tonë për integrim në NATO dhe Bashkim Evropian, kemi arritur që bashkërisht me partnerin e koalicionit të bëjmë një riformatizim afirmativ të kabinetit qeveritar. Se a i uron dikush apo nuk i uron, siç u përmend këtu edhe nga zoti Rexhepi, ministrat e ri, është çështje krejt personale, por dua të theksoj se është mirë që zoti Rexhepi ta lexosh shumë mirë Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe autoritetin e mandatarit apo të kryeministrit të Kosovës. Të kisha lutur që bile së paku mos kërko si në Gjilan, rivotim.

Ministri i Bujqësisë, i nderuari Blerand Stavileci, është ekonomist me gradën master, është rritur dhe është edukuar me libra në dorë, zoti Malok.

KRYETARI: Faleminderit! Për replikë, deputeti Fatmir Rexhepi, se ia keni përmendur emrin. Mos përmendni emra shumë!

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryetar! Unë mendoj që megjithatë është shumë serioze ajo çka duhet të merret edhe nga kryeministri. Unë sot do ta votoja, pra, me votën time kabinetin qeveritar, por edhe njëherë po them që legjitimiteti i saj do t'i mungojë gjatë gjithë kohës. Është dashur një votë formale për të pasur një legjitimitet të plotë, se përndryshe do t'i kemi... Unë nuk po kërkoj rivotim, por po kërkoj, do të thotë, votën formale që i duhet, prandaj mendoj që është më mirë të kemi një Qeveri me legjitimitet të plotë, që e autorizon Parlamenti, se sa ta kemi gjysmën legale gjysmën ilegale – qeveri në hije, prandaj unë lus që më mirë është kjo sesa ajo tjetra. Përndryshe, sa i përket rivotimit unë e kam shprehur timin atje. Pra, i mbetet kryeministrit të ketë qëndrim publik ndaj Gjilanit..., çka ka bërë në Gjilan, qysh i ka blerë votat. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka kërkuar fjalën për replikë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar zoti Rexhepi! Unë nuk besoj që edhe zoti Ahmet Isufi pajtohet me ju, në këtë rast, sepse rezultatin zgjedhor e kishit në Gjilan 1200 vota me diferencë dhe doli mbi 6000 vota me diferencë minus, besoj që po qe se futet edhe këtu ndonjë votim, do të fitojnë edhe më tepër se sa që mund të ndodhte në një rast

të zakonshëm të partneritetit politik që e kemi, kështu që mendoj se do të ishte me interes të lexohet dhe të kuptohet dhe të interpretohet drejt Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Replikë, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Unë s'e di çka ia zura udhën në këtë rast kryeministrit, pa asnjë arsye, veç a kishte bërë të ma shpjegoni fjalën "afirmim", çka është për Qeverinë, në këtë rast, se s'po e kuptoj.

KRYETARI: Faleminderit! Replikë, Gani Koci!

GANI KOCI: Zoti kryetar, unë nuk po replikoj me askënd, vetëm dua ta lexoj nenin 94 të Kushtetutës, pikën 4. Kompetencat e kryeministrit, do të thotë. "Kryeministri ndërron anëtarët e Qeverisë pa pëlqimin e Kuvendit".

KRYETARI: Faleminderit, deputet Gani Koci. Fjalën e ka kryeministri, replikë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Jo, nuk është replikë, por është sqarim për kolegët Rexhepi dhe Isufi. "Afirmim" për demokracinë është kur Qemajl Mustafa fiton mbi 6000 vota diferencë ndaj jush, për demokraci.

KRYETARI: Faleminderit! Replikë, Fatmir Rexhepi!

FATMIR REXHEPI: Se a është në interes të legjitimitetit, le ta thonë ministrat, kolegë të mi deputetë, është çështje e tyre, unë i respektoj shumë. Thashë, do t'i kisha votuar. Mendoj që mbetet pa legjitimitet.

Ndërsa sa i përket kësaj tjetrës, të Parlamentit, sa i përket kësaj pjesës çka thotë kryeministri, ai me qëllim po provokon. Sido që të jetë, atëherë më detyroi t'i them diçka tjetër. 1000 vota i keni vjedhur, zoti kryeministër, më 13 dhjetor. 5000 vota, zoti kryeministër, ti me kabinetin qeveritar i ke blerë, e ke korruptuar sistemin zgjedhor në Gjilan dhe e ke fituar. Unë ta kam uruar ty. Kurrfarë problemi nuk ka. E ke instaluar një kryetar, punoni, puna e mbarë ju qoftë! Por, e keni degjeneruar një sistem demokratik dhe i keni ulur të gjitha vlerat demokratike, ju zoti kryeministër, me paratë e Qeverisë, me milionat që i keni dhënë dhe e keni blerë vullnetin e qytetarëve të Gjilanit. Mendoj se kjo nuk ju bën nder, prandaj fitorja është gjithfarë, por jo...

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar kryeministri! Edhe Ahmetit, ia jap edhe një herë, s'ka më shumë të drejtë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Rexhepi, unë mendoj që këtë debat do të duhej ta zhvilloje në Gjilan. Nuk është në interesin e askujt të fyhen qytetarët e dashur e të respektuar të Gjilanit. Pikërisht nga këto sharje, akuza, ofendime dhe fyerje për qytetarin e Gjilanit, kur e kishte një diferencë prej 1200 – 1300 votash, u ndëshkove me mbi 6000

vota, sepse gjithmonë i ke marrë Gjilanit dhe kurrë s'ke investuar në jetën tënde për qytetarët e Gjilanit dhe qytetin e Gjilanit. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë një minutë, e ka fjalën deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Jo, vetëm dy fjalë, s'ka nevojë një minutë. Unë kryeministrit i kisha thënë – nuk është mirë, pa asnjë shkas të bëjë polemika këtu dhe të përmend emra. E dyta, unë po e plotësoj që i ka blerë votat, është e vërtetë dhe i ka blerë bashkë me një ministër që e ka emëruar dje, hiq më larg, dhe e din cili është ai – Lutfi Haziri!

KRYETARI: Konsideroj se debati është kryer. Vazhdojmë!

(Reagim)

S'ke të drejtë. të lutem, s'ke të drejtë! Deputet, e ke shfrytëzuar, s'ke të drejtë. Shko në vend, ose dil jashtë, të dyja janë, zgjedhe, e ke kryer fjalën. Ju lutem!
Po, lexojeni Rregulloren atëherë, ju jeni deputet disa mandate.

(Polemikë)

Ju lutem, kërkon debat, debaton. Fjalën e ke marrë, dy herë ke replikuar, u krye puna. Vazhdojmë me votim. Kemi propozimin e Qeverisë.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim, votojmë tash.

Konstatohet se me 41 vota “për”, 30 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi Propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

- **Miratimi i rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për Propozimin – strategjinë për energjinë për periudhën 2009 – 2018**

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me debatin e zhvilluar në seancën plenare të mbajtur më 18 mars 2010, ka rishqyrtuar Propozimin – strategjinë e energjisë për periudhën 2009 – 2018 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Para se të procedohen në votim rekomandimet e Komisionit, ftoj kryetaren e komisionit funksional, zonjën deputete Muzejene Selmani apo raportuesin e komisionit për arsyetimin e rekomandimeve.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe pse, siç po shihet, këtu aspak s'ka demokraci dhe puna e komisionit nuk është kah respektohet, të ketë mirëkuptim prej jush, si kryetar i Kuvendit, se prej ekzekutivit aspak, unë do t'i lexoj rekomandimet e Komisionit lidhur me strategjinë.

Pikësëpari, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion nxori 5 rekomandime:

1. Resurset e linjitit të vihen në dispozicion dhe shfrytëzim në pajtim me kapacitetet e reja gjeneruese të energjisë dhe në harmoni me interesat zhvillimore të Kosovës;
2. Të krijohet ambient ligjor për konkurrencë dhe tregun e lirë në fushën e sektorit të energjisë;
3. Termocentrali "Kosova B" mos të përfshihet në pakon e tenderimit së bashku me "Kosovën e Re", por të mbetet sipas Strategjisë së energjisë e cila është diskutuar brenda Kuvendit;
4. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të bëhet në bazë të interesit afatgjatë për Kosovën, në fazën e parë kapaciteti 1000 megavat, me mundësi të ndërtimit të kapaciteteve të tjera në harmoni me kërkesat dhe bilancin energjetik të vendit në rajon;
5. Qeveria e Kosovës detyrohet të harmonizojë planin e veprimit me Strategjinë e energjisë, të miratuar në periudhën 2009 – 2018.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka për Strategjinë e energjisë, kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar, Krasniqi!

Të nderuar ministra, zëvendësministra,

Të nderuar deputetë,

Zonja e zotërinj,

Në strategjinë tonë të rishikuar, do me thënë në Strategjinë për energjinë 2009-2018, Qeveria e Republikës së Kosovës në mënyrë të qartë vlerëson se përdorimi efektiv i burimeve tona energjetike është jetik për të siguruar rritje ekonomike të qëndrueshme për vendin tonë në të ardhmen.

Strategjia paraqet këndvështrimin tonë afatgjatë për këtë sektor të rëndësishëm dhe mbulon një gamë të plotë dhe komplekse të çështjeve në këtë sektor.

Strategjia i parasheh objektivat tona të përgjithshme në politikat përkatëse, por nuk do të përmend sot çdo detaj të asaj që do të bëjmë ne për të arritur këto objektiva.

Zbatimi i Strategjisë duhet të jetë fleksibil dhe pragmatik për të përmbushur nevojat tona reale.

Projekti “Kosova e Re” gjatë gjashtë muajve të fundit, me angazhimet tona që kemi pasur si Qeveri e Republikës së Kosovës, kemi marrë vendime të vështira, por adekuate lidhur me transaksionet për “Kosovën e Re”. Ne na është dashur që të pranojmë realitete të papëlqyera që janë krijuar për shkak të krizës globale financiare dhe ekonomike dhe që kanë ndikuar tek investitorët e mundshëm në këtë projekt.

Gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar ne rishikuam strukturën e transaksionit për “Kosovën e Re” për t’i pasqyruar këto realitete, duke kërkuar mënyra më efektive për të ecur përpara dhe për t’i adresuar nevojat reale energjetike të Republikës së Kosovës.

Pakoja që po e ofrojmë tani përfshin jo vetëm zhvillimin e minierës së Sibovcit, por edhe rehabilitimin e njërive ekzistuese të “Kosovës B” dhe një qasje me faza për ndërtimin e termocentralit gjenerues të ri dhe modern, duke filluar me fazën fillestare 600 megavat dhe duke përfshirë edhe një fazë të dytë, gjithashtu, plus 600 shtesë. Ky është fillimi i strategjisë për energjinë, janë bërë hapat e parë, por jo të fundit.

Synimi i projektit “Kosova e Re” është që të sigurojë që Kosova të ketë sukses në afatin sa më të shkurtër dhe të realizojë investime të domosdoshme pa vonesa tjera të cilat do të mund të rrezikojnë këto investime. Suksesi do të jetë çelës i zhvillimit të ardhshëm të resurseve tona të linjitet, por edhe për më shumë prodhim të energjisë. Vetëm para dy javësh kishim mundësi që ta prezantojmë listën e ngushtë me 4 konzorciume ofertuese të forta të parakualifikuara, duke përfshirë dy nga ofertuesit e mëhershëm.

Kjo do të thotë se ne do të vazhdojmë me logjikën dhe filozofinë tonë, përkushtimin tonë shumë ofertues, që nënkupton konkurrencë të lirë. Konkurrenca do të sigurojë furnizim të qëndrueshëm me energji, me çmimin më të volitshëm të mundshëm dhe ky do të jetë rezultati më i mirë për shtetin e Kosovës dhe për qytetarët e Kosovës.

Përfundimi i suksesshëm i transaksioneve për “Kosovën e Re” këtë vit do t’i hapë rrugë shfrytëzimit të potencialit të plotë të strategjisë për energjinë dhe do të jetë çelës për rritjen ekonomike të Kosovës në të ardhmen.

Një sukses nxiti suksesin tjetër, duke dëshmuar se mund të negociojmë, ndërtojmë dhe financojmë këtë fazë të parë dhe jemi duke ndërtuar reputacionin e Kosovës në industrinë globale të energjisë. Ky sukses do të jetë dhe do ta bëjë Kosovën partner edhe më joshës deri sa të kalojmë tek ndërtimi i fazës tjetër.

Të nderuar deputetë, të gjithë e kuptojmë domosdoshmërinë për të investuar sa më parë në sektorin e energjisë. Investimet në këtë sektor, përveç se do të zgjidhin problemin e furnizimit me energji elektrike dhe përveç se do të sigurojnë rritje ekonomike të qëndrueshme – këto investime e bëjnë Kosovën akter të rëndësishëm jo vetëm në rajonin tonë, por edhe më gjerë. Për më tepër, këto investime do ta lirojnë përfundimisht shfrytëzimin e buxhetit të Kosovës për investime në këtë sektor dhe vetëm në këto dhjetë vitet e fundit janë investuar mbi 1.200.000.000 euro nga buxheti. Prandaj, tani është koha që në këtë sektor të kemi investime të fuqishme të huaja, ndërmjet të cilave ne do të fillojmë të shfrytëzojmë kapacitetet tona energjetike.

Në përfundim, duke qenë i bindur se ju e kuptoni të gjithë, pa dallim, domosdoshmërinë e realizimit të këtyre projekteve nacionale, duke qenë i vetëdijshëm se me miratimin e kësaj strategjie ne iu hapim rrugë investimeve të fuqishme në sektorin e energjisë dhe e rrisim zhvillimin ekonomik, unë ju ftoj të gjithë juve, deputetë të nderuar, që ta miratojmë këtë strategji, sepse kjo është në interes të vendit tonë dhe përmes saj iu hapim rrugë investimeve të huaja të fuqishme të cilat do të rrisin mirëqenien e qytetarëve tanë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Nuk ka debat, debati u krye, ju e dini.

Vazhdojmë me votimin e Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018, me rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion.

Ministre, ne e kemi ngarkuar seancën për diçka, urdhëroni, e keni fjalën. Urdhëro, ministre, sqaroje këtë edhe një herë, para se të shkojmë në votim.

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA – PULA: Të nderuar deputetë, Kjo strategji bazohet në Programin e Qeverisë për sektorin e energjisë, si dhe në platformën e politikës energjetike të Kosovës, të përgatitur nga bashkëpunëtorët apo këshilltarët vendorë dhe ndërkombëtarë nga Banka Botërore dhe USAID-i.

Strategjia që propozoj ta miratoni, sot bazohet në një analizë të plotë që ne e kemi kryer për situatën e sektorit energjetik dhe të nevojave për energji për periudhën dhjetëvjeçare 2009-2018.

Strategjia është ndarë në dy pjesë, sikur që e kemi prezantuar herën e kaluar dhe sa i përket strategjisë, është plotësisht në përputhje me politikat dhe objektivat edhe të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe me programin e Qeverisë.

Të nderuar deputetë,

Kur është çështja sa u përket pyetjeve të komisionit parlamentar për rekomandime, herën e kaluar kanë qenë tri rekomandime, ndërsa tani janë pesë rekomandime. Më vjen keq që këto rekomandime janë rritur për tri rekomandime të reja apo për tri pyetje të reja, të cilat janë plotësisht në pajtueshmëri me Strategjinë të cilën e keni pasur dhe e keni tani. Po flasim për pyetjet apo rekomandimet të cilat janë plotësisht në pajtueshmëri me këtë strategji: të vendoset ambienti ligjor për konkurrencë dhe treg të lirë në sektorin energjetik. Strategjia, po jap përgjigjen, Strategjia për energjinë përmban përputhshmërinë me Bashkimin Evropian dhe me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, përfshirë konkurrencën dhe tregun e lirë, ashtu që plani i veprimit do t'i trajtojë këto shqetësime.

Kjo strategji, të cilën e keni kërkuar, dhe plani i veprimit, më vjen keq që këtu shumica prej jush që nuk janë direkt të lidhur me strategjinë, i bëjnë disa pyetje dhe kërkojnë plane të veprimit në strategji.

Strategjia në përgjithësi nuk hyn në detaje, por jep strukturën, plotësisht e jep strukturën dhe këtu kemi strategjinë për dhjetë vjet 2009-2018, ndërsa secila ministri, që ju keni shumë përvojë që keni qenë ministra dhe keni punuar në kabinete ministrare, sa iu përket strategjive përgatitet edhe programi për veprimin e strategjive çdo tri vjet, që do të thotë se e kemi edhe periudhën 2009-2011. Do të thotë, sa u përket planeve të zbatimit të kësaj strategjie, janë të përcaktuara dhe janë aprovuar në Qeveri sipas politikave dhe programeve të Qeverisë.

Rekomandimi tjetër, thotë: Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese... Po, unë po i lexoj rekomandimet dhe dëgjoni përgjigjet. ... Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të bëhet në bazë të interesave afatgjate të Kosovës në fazën e parë kapacitetet 1000... dhe pastaj vazhdon.

Ky rekomandim është i qartë dhe plotësisht është në përputhje me strategjinë të cilën e keni parë. Këtu parashikohet, në bazë të planit dinamik të kërkesës për konsumin e energjisë, deri në vitin 2018 të ndërtohen 1000 megavat, pavarësisht a do të jenë 500 apo 600, ajo varet prej teknologjisë të cilën investitori do ta propozojë. Ne s'mundemi investitorit t'ia caktojmë 500 apo 600, sepse ka teknologji të reja dhe kryesisht të gjitha ato duhet të jenë në pajtueshmëri me direktivat e BE-së sa i përket ndotjeve dhe çështjeve tjera globale. Prandaj, faza tjetër parashikohet pas vitit 2018 sipas nevojës dhe kërkesës së konsumit, e cila parashikohet në dinamikën e konsumit të energjisë elektrike.

Rekomandimi tretë, thotë: Qeveria e Kosovës obligohet që të harmonizojë planin e veprimit me strategji për energji, të miratuar për periudhën 2009-2018. Plani i veprimit është në harmoni të plotë me strategjinë dhe implementimi i strategjisë përmes planit të veprimit do të sigurojë që të mbështesë arritjen e objektivave për furnizim të sigurt me energji dhe me çmim më të ulët të mundshëm për konsumatorët e Kosovës. Ky është ai plani të cilin e keni kërkuar.

Janë dy pika tjera të cilat janë më të ndjeshme dhe për të cilat me siguri ju edhe kërkon përgjigje. Janë resurset e linjtit dhe si do të menaxhohen resurset e linjtit. Sa për resurset e linjtit apo minierën e linjtit, ajo planifikohet edhe me Kushtetutë, por edhe me të gjitha normat tjera që të jepen me ligj të veçantë, ndërsa ligjin e veçantë e kemi Ligjin e minierave, i cili besoj që së shpejti do të vijë në këtë Kuvend. Dhe, sipas Ligjit të minierave, parashikohet se si do të menaxhohen dhe si do të jepen të gjitha resurset dhe në kuadër të këtyre resurseve parashikohet edhe miniera e Sibovcit.

Dhe, po ashtu, edhe në strategjinë e cila është para jush, të cilën unë besoj se do ta miratoni për shkak se kjo parashikon të gjitha veprimet e proceseve për tërheqjen e investitorëve të huaj. Në kuadër të kësaj strategjie parashikohet miniera e Sibovcit në një hapësirë pak më të madhe dhe planifikohet për një periudhë më të gjatë, ndërsa në kuadër të projektit "Kosova e Re" për shkak të shumë efekteve dhe për shkak të shumë kushteve ka ardhur deri te një ristrukturim, të cilin e arsyetoi edhe kryeministri. Miniera e Sibovcit, e cila është diskutuar mjaft edhe në Komitetit drejtues të projektit, e që në Komitetin drejtues të projektit janë ekspertët dhe përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme,

përfaqësues të institucioneve vëzhguese dhe shumë ministra, kanë marrë vendim që miniera e Sibovcit apo fusha e Sibovcit t'i afrohet investitorit të ri për aq megavat sa do të gjenerojë, që do të thotë se do të furnizojë Termocentralin "A", Termocentralin "B" dhe do ta furnizojë termocentralin e ri me kapacitetet me të cilat do të operojë në fillim dhe pastaj me kapacitete me të cilat do të operojë në fazën e dytë. Dhe, të gjitha këto janë në këtë strategji, mirëpo ndoshta nuk janë të detajuara, prandaj kishte qenë mirë që kur flisni për një strategji, ju lutem, analizoni edhe të gjitha ato grafikone, ato tabela dhe do të shihni se ekziston një dinamikë se si do të shfrytëzohet Sibovci, se si do të rriten kapacitetet gjeneruese, se si do të rriten edhe kërkesat e konsumit për nevojën e sektorit të energjisë. Ndërkohë, është këtu edhe Termocentrali "Kosova B" që është një prej termocentraleve e cila në Kosovë operon dhe i plotëson të gjithë konsumin të cilin e kemi për momentin. Termocentrali "Kosova B" është një termocentral i cili operon në Kosovë dhe për momentin është mbi 30 e sa vite i vjetër. Çdo termocentral e ka një periudhë të jetëgjatësisë së tij, prandaj ai jo vetëm që duhet të rivitalizohet, por në fakt ka nevojë edhe për investime permanente të cilat i ka.

Sa i përket Termocentralit "Kosova B" gjithashtu është në këtë strategji, por nuk është e detajuar se në cilin transaksion do të marrë pjesë. Ne, në kuadër të projektit "Kosova e Re" pasi i kemi këshilltarët e transaksionit, kemi pasur opsionin që "Kosova e Re" të hyjë në kuadër të projektit "Kosova e Re" për shkak se janë këshilltarët e transaksionit dhe ata do të menaxhojnë apo do të japin propozime më të arsyeshme sa i përket zhvillimit të Termocentralit "Kosova e Re" dhe rivitalizimit të Termocentralit "Kosova B". Prandaj, në këtë projekt, nëse dëshirojmë të plotësojmë strategjinë, atëherë plotësimi i strategjisë do të jetë vetëm sa i përket Termocentralit "B" i cili parashikohet të rivalizohet me një partneritet publik0 – privat dhe ky partneritet publiko – privat mund të hyjë në kuadër të transaksionit të Termocentralit "Kosova e re". Këto janë sa i përket arsyetimeve dhe të gjitha rekomandimet, edhe një herë po e cek, ju lutem deputetë, të nderuar deputetë, po ju ceku se të gjitha rekomandimet të cilat janë të parashtruara nga ky komision, janë në këtë strategji, janë në këtë plan të zbatimit, i cili parashikohet vetëm për tri vjet 2009 – 2011. Çdo plan i zbatimit për shkak të ndryshimeve të cilat vijnë, parashikohen të rishikohen për vitet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pasi veç filluam, kemi gjashtë vetë të lajmëruar për fjalë dhe jo shtatë, por gjashtë. Fjalën fillimisht e ka ministri për Ekonomi dhe Financa, Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kolegë ministra dhe deputetë,

Jemi në fazën përfundimtare të fillimit të projektit madhor për sektorin e energjisë. Që gjashtë vjet po thuaj se jemi duke u sjellë dhe pështjellë dhe s'po ia nisim ndërtimit të energjisë elektrike. Disa rekomandime të cilat janë dhënë nga Komisioni, vërtet janë dhe mund të pranohen në strategjinë dhe nuk janë në kundërshtim me strategjinë. Për të qenë efikas në sqarimin e çështjeve, si anëtar i Komitetit Drejtues të "Kosovës së Re" dhe si ministër i Ekonomisë dhe Financave do të doja t'i them ca fjalë lidhur me këtë.

Në pikën 11.2.4. të strategjisë, e cila përfshin faktikisht rekomandimin e Komisionit për Energji, Tregti dhe Ekonomi, nevojitet shtimi i një fjalie dhe aty absolutisht nuk kemi kundërshtime. “Dokumentacioni final”, po citoj, “i tenderit për “Kosovën e Re” do të përmbajë një pjesë adekuate të rezervave nga miniera e re në pajtueshmëri me kapacitetet e reja gjeneruese”. Pra, e zvogëlon hapësirën që do t’i jepet “Kosovës së Re” e jo tërë sipërfaqja e Sibovcit dhe konsideron që me këtë fjali jemi absolutisht në përputhje me rekomandimet e Komisionit për Energji dhe Miniera.

Rekomandimi i dytë, sa i përket “Kosovës B” – Strategjia e energjisë e cila është për aprovim, në fakt e përfshin edhe “Kosovën B” dhe do të citoja: “Strategjia e energjisë”, thotë, se “rehabilitimi i “Kosovës B” do të jetë subjekt i partneritetit publiko-privat”. Pra, zbatimi i partneritetit publiko-privat në kuadër të strategjisë është paraparë, nuk është precizuar saktë në strategji se a duhet në mënyrë specifike të jetë “Kosova B” apo nuk duhet në strategjinë, andaj neve rekomandimin e Komisionit ndërministror e pranojmë në mënyrë të pjesërishtme me shtesën e një fjalie, në nenin 11.2.5. duhet të jetë një fjali e vetme: “sektori privat do të përfshihet në kuadër të transaksionit “Kosova e Re”. Me këtë fjali, në fakt, në një mënyrë apo tjetër plotësohet strategjia, votohet strategjia, ndërsa tri rekomandimet tjera të Komisionit aprovohen plotësisht nga ana juaj.

Më lejoni të vazhdoj edhe pak arsyeshmërinë! Çështja e aspektit financiar, “Kosova B” si dhe e gjithë pjesa e KEK-ut ka nevojë për investime marramendëse, nëse mund të them. 1.200.000.000 euro janë dhënë deri më sot për energjinë dhe ende s’kemi energji. Për rivitalizimin e “Kosovës B” në vitet e ardhshme, të paktën 160.000.000 euro nevojiten. Në qoftë se ne e zgjedhim këtë alternativë, do të thotë se do të kemi 160.000.000 euro më pak para për pensionistët, për veteranët, për çfarëdo aspekti tjetër social. Unë, si ministër i Ekonomisë dhe Financave, po ju them, do ta kemi shumë vështirë para jush, para Fondit Monetar dhe para të tjerëve të arsyetohej që të vazhdojmë të rivitalizojmë institucione, përkatësisht ndërmarrje të cilat vërtet meritojnë të kalojnë në sektorin privat.

Katër nga investitorët, të cilët kanë paraqitur oferta e tyre, i japin shumë qartë çështjet e kërkesave të tyre, se në qoftë se pjesët vitale të “Kosovës së Re” nuk do të jenë pjesë, do të ikin nga Kosova. Ka pas raste dhe ka dikush mbase në dëshirë, në regjion apo s’dua të komplikoj, që këta investitorë dhe këta të cilët janë të ikur nga Kosova, nuk është në interesin e Kosovës kjo. Në aspektin e çështjes së përfshirjes së “Kosovës B” në këtë projekt dhe benifiteve që i merr populli i Kosovës, çdo përfshirje më e madhe e ndonjë asemi që ka vlerë, do të thotë pjesëmarrje më e madhe e Kosovës në përqindjen si aksionar, si Qeveri. Kalkulimet tona dhe këshilltarëve të transaksioneve dalin se në qoftë se “Kosova B” përfshihet, mundësia e Republikës së Kosovës për të marrë pjesë si hisedar do të rritet. A do të jetë 25% apo 30%, ajo është çështje që e përcakton vetë tregu, sepse përzgjedhja e fituesit do të jetë në bazë të ofertës për rrymën më të lirë të prodhuar në Kosovë. Rryma më e lirë e prodhuar në Kosovë do të thotë pjesëmarrje më e madhe e Qeverisë së Kosovës në kuadër të këtij projekti. Më vjen keq që e ngrita tonin, sepse ishin çështje që duhet të mbizotëroja nga intervenimet nga ana jashtë, por do t’ju kisha lutur të shikoni këtë si një moment në të cilin duhet të merren vendime të cilat do të zgjidhin përfundimisht nyjën e problemit të energjisë elektrike.

Ne nuk do të mbështesim variante dhe do t'ju kisha lutur të mirëkuptoni. Variante të cilat, nën një, dekurajojnë investitorët dhe, nën dy, e ngarkojnë buxhetin e Kosovës për ato pjesë për të cilat sektori privat është i interesuar, të paktën. Andaj, me aprovimin e Strategjisë të cilën e ka prezantuar Ministria e Energjisë dhe e Minierave dhe me aprovimin e pjesërishëm, por jo të nenit 2, përkatësisht rekomandimit 2, ne jemi absolutisht në përputhje me të gjitha nevojat e shoqërisë kosovare që të kemi energji të lirë dhe të kemi investime të huaja të cilat, sipas kalkulimeve, do të jenë rreth 1 miliardë euro vetëm për 500 deri 600 megavat.

KRYETARI: Ju e dini që debati ka përfunduar. Megjithatë, mund të shkojmë me nga një deputet në emër të grupeve politike, jo më shumë. Në emër të LDK-së, fjalën e ka kërkuar Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: I nderuar zoti kryetar,
I nderuar kryeministër, kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Vërtet, çështja e strategjisë dhe rekomandimet e komisionit dallojnë. Nuk mund të themi se nuk dallojnë. Dallohet te çështja e basenit të Sibovcit, që në fakt aty nuk është dallimi aq i madh, sepse në qoftë se Komisioni ka kërkuar me rekomandime të veta që të ruhet, do me thënë të kufizohet mundësia e shfrytëzimit me projektin e ri, ajo po plotësohet me strategjinë, kështu që nuk ka dallime të mëdha.

Dallimi esencial qëndron te Termocentrali “Kosova B”. Në qoftë se e kemi kriter themelor çështjen e ruajtjes së buxhetit të Kosovës, nën një, dhe kriter të dytë – inkurajimin e investitorëve të huaj, ne duhet të respektojmë projektin e “Kosovës së Re”. Këtë e them duke u mbështetur në kërkesën e investitorëve - numër një - ne mund të ruajmë edhe “Kosovën A” edhe “Kosovën B” dhe të gjitha, por nuk kemi investitorë. Qëllimi esencial është të inkurajojmë investitorë për “Kosovën e Re” dhe të fillojmë të kemi momentin për të filluar investime... Ju lutem, unë ju dëgjova me kujdes dhe lus, sepse çështja është krejtësisht racionale. Nuk janë populizëm këto. Ata që donë ta shikojnë projektin... Ju lutem, nuk të ndërhyra, të respektoj, respektoje fjalën e lirë. Ti mundesh ministrave t’u ndërhysh, unë jam deputet sikur ti. Të lutem, del e më kundërshtoj këtu, të lutem!

Parimisht, po e them, në qoftë se doni investitorë të huaj, shanset për të hy ai investitor i huaj me mundësi potenciale ekzistuese në Kosovë janë të hyjë në projekt edhe “Kosova B”, numër një. Pse? Kur e them këtë, i kam arsyet. A dëshironi të mbani “Kosovën B” dinozaur, që për çdo vjet i japim nga 40 milionë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës? Vërtet, “Kosova B” gjeneron energji elektrike dhe ka mundësi të menaxhimit të mirë, por në këto kushte dhe rrethana, si është duke u menaxhuar sot, nuk ka shans Termocentrali “Kosova B” të funksionojë në normalitet dhe të na sigurojë fitime. Ne nuk kemi ende fitime prej këtij kapaciteti. Andaj, qëllimi është shumë i arsyeshëm. Unë besoj se do të gjejmë përkrahje edhe te të gjithë deputetët. Nuk është fjala këtu të përkrahet as individ, as grupi. Është çështja te Kosova. Ju lutem, “Kosova B” nëse hyn në këtë projekt dhe të njëjtën kohë i jepet shans partneritetit privato-publik, ne në fakt nuk kemi ra fare në

kundërshtim me Ligjin e privatizimit, që do të thotë edhe pse ka hyrë në “Kosovën e Re”, ajo mund të privatizohet. Duke i marrë parasysh këto dy kategori, ruajtjen e buxhetit, në njërin anë, dhe në anën tjetër – inkurajimin e investitorëve të huaj në Kosovë, unë mendoj që i plotëson kushtet Strategjia që e prezantoi ministria. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ethem Çeku!

ETHEM ÇEKU: Jo, i thashë që duke respektuar anën profesionale të ministrit të Ekonomisë dhe Financa, bile së paku në shifra të jetë më i saktë. Po, faleminderit! Po i drejtohem kryeministrit, për arsye se e di që ka një përgjegjësi të jashtëzakonshme në situatën e marrjes së vendimit për energjetikë dhe për projektin “Kosova e Re”. Dua të them edhe me gjithë ndjenjën më të mirë, do të mbështesim që sa më parë të kemi të ndërtuar blloqe të reja. Në çfarëdo rrethane, jemi mbështetës që Kosova të ikë nga blerja e shtrenjtë e energjisë elektrike.

Kryeministër, informacionin që po ta japin, nuk është i saktë, është i gabuar. E them publikisht para krejt opinionit dhe me të gjitha përgjegjësitë e mia, janë të gabuara, se “Kosova B”, rehabilitimi i “Kosovës B” në qoftë se themi që po duam ta japim në një pako tenderuese “Kosovën B” dhe se nevojiten 160 milionë euro, asnjë studim deri më tani që duhet t’i çelim... blloqet edhe të arrijmë të dimë se duhet 160 milionë, nuk është bërë. Këtu janë disa parafraza, disa paragjykime, se për kaq vite duhet të shpenzojmë për rehabilitimin e blloqeve të “Kosovës B”. Ky është problemi i parë, do të thotë.

Problemi i dytë është se a është profitabile, në qoftë se e mbajmë ne, çka fitojmë si Kosovë, si Qeveri? Do të thotë, në qoftë se flasim se “Kosova B” prodhon 3.200.000 megavat, e kamë thënë edhe në seancën e kaluar, dhe po të shumëzojmë atë me çmimin që e faturon qytetari, na del një shumë e jashtëzakonshme që “Kosova B” prodhon. Është profitabile dhe për këtë na kanë thënë – në qoftë se nuk e vendosim “B”-në në pako, investitorët nuk na vinë dhe është shumë e qartë se investitori në radhë të parë ka profitin të blloqet e “Kosovës B”. Është diçka tjetër a marrim vendim për t’ia dhënë a jo, por nuk duhet të marrim diçka që ne e mbështjellim.

“Kosova B” është profitabile! Kryeministër, këqyre ku është projekti, që është nga këshilltarët e transaksionit, të cilët i kemi zgjedhur ne këshilltarët e transaksionit dhe e keni shumë pastër. Profiti i pastër në blloqet e “Kosovës B” është 10 milionë euro, i pastër, me të gjitha ngarkesa sociale ekonomike që i kemi ne tani. Do të thotë, me të gjitha ngarkesat i kemi 10 milionë profit të pastër në “Kosovën B” që ia lë Kosovës. Ky është studimi që është krye nga këshilltarët e transaksionit dhe nga të cilët janë dhënë të gjitha të dhënat. Dhe ne tash vendosim a duam ta japim, a është profitabile ta japim apo s’është profitabile ta japim.

Problemi tjetër shumë i madh është të miniera e Sibovcit. Në strategji ka mbetue e hapur çështja e minierës së Sibovcit dhe nuk është precizuar. Ne në rekomandime e kemi bërë një punë të shkëlqyer që kemi kërkuar që kapacitetet e reja që ndërtohen, licenca që merret për minierën e Sibovcit të jetë në harmoni me kapacitetet e reja gjeneruese. Në qoftë se gjeneron dhe duam t’i ndërtojmë 500 apo 600 megavat, atëherë le të merret

licencë për hapësirën që duam ta ndërtojmë. Prandaj, kemi bërë rekomandime, bile kemi qenë shumë të kujdesshëm që rekomandimet të jenë konform zhvillimeve të sektorit dhe konform që projekti mos të ketë asnjë vështirësi. Do të thotë, kemi kërkuar që mos t'i jepet licenca për një miliardë tona linjit dhe të ndërtohet 50-megavatëshi, por në qoftë se i jepet licenca, t'i jepet kohë pas kohe.

Te "B"-ja, edhe një herë duhet të kthehem. Edhe si komision, po edhe ne, nuk e kundërshtojmë idenë që duhet të futet kapitali privat, siç është paraparë në strategji. Do të thotë, pas disa vitesh bëhet studimi dhe i investohet kapitali privat në "B", por jemi kundër vendosjes në një pako tenderuese, sepse mendoj nuk i shkon në favor të zhvillimit ekonomik, nuk shkon në favor të konkurrencës së lirë dhe ne na kanë thanë që ju jeni vend i vogël dhe çka ju nevojitet konkurrenca, nuk keni nevojë për konkurrencë. Po ashtu, është thënë që blloqet e "B"-së duhet ta ruajnë një lloj konkurrence, një lloj kundër monopolit. Prandaj, edhe ne në rekomandime e kemi shtruar kërkesën që mos të jetë në një pako, sepse duhet të kemi mundësinë e ruajtjes së një procesi konkurrues në tregun e Kosovës.

Po ashtu, rreth kapaciteteve është biseduar shumë. Në bazë të bilancit strategjik që na ka sjell Ministria, dhe ne e mbështesim, është përcaktuar çështja e kapaciteteve. Ne e dimë se kriza globale ekziston, e dimë që ka probleme në fushën e energjisë elektrike, e di që atë që e përmend me të drejtë se janë bërë investime të mëdha dhe nuk kemi arritur të kemi sukses në fushën e caktuar. Mirëpo, vetëm merrni shembull shpenzimet e fundit që janë duke u bërë me blerjen e energjisë me çmime aq të shtrenjta. Prandaj, kemi kërkuar që në bazë të bilancit energjetik, jo në forma të tjera, të aprovohet dhe të mbështetet strategjia.

Realisht, rekomandimet e komisionit nuk janë në kundërshtim me strategjinë, nuk janë në kundërshtim në strategji, përpos që ne kemi qenë më të prerë dhe kemi kërkuar që "B"-ja, blloqet e "B"-së të mbesin jashtë pakos së këtij tenderi, por të shikohet të bëhet studimi dhe të hyjë kapitali privat në një fazë të caktuar, në një fazë tjetër, jo tani në një pako të projektit.

Në qoftë se thuhet se nëse ne e heqim nga pakoja këtë projekt, nuk na vinë investitorët, nuk e besoj, sepse nga takimet e kaluara ka pasur shumë bile rezistencë që blloqet e vjetra mos të jenë fare në projekt. Është kërkuar që të kemi vetëm blloqet e reja, në të cilët mund të investohet.

Unë personalisht ndaj opinionin, mendimin tim – ne duhet të mbështesim që ne sa më shpejtë të vijmë te ndërtimi i blloqeve të reja, të mbështesim strategjinë, të aprovohen rekomandimet të cilat i kemi bërë, si komision, dhe strategjia dhe rekomandimet të shkojnë së bashku për sektorin në energjetik. Faleminderit!

KRYETARI: Mendoj që ka ende deputetët, pastaj e merr fjalën. Po për sqarime, ka edhe deputetë tjerë që ua kam dhënë fjalën. Pra, ta kryejmë me deputetët. Në emër të AKR-së, Heset Cakolli e ka fjalën.

HESET ÇAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Strategjia për energjinë është kaheër temë e debatit edhe e institucioneve, edhe e shoqërisë civile dhe e palëve të interesit, prandaj ne si Grup parlamentar e mbështesim çdo iniciativë që ka të bëjë me strategjinë dhe ka për qëllim përmirësimin e gjendjes së energjisë në vendin tonë.

Pa një stabilizim të gjendjes së energjisë në vendin tonë, nuk pritet zhvillim ekonomik. Ne jemi dëshmitarë se që 10 vite janë investuar shuma të mëdha të mjeteve dhe gjendja, fatkeqësisht, edhe më tutje është jo e mirë.

Ne angazhohemi që strategjia si strategji të aprovohet dhe të krijohen kushte të favorshme për investitorë të mundshëm potencialë. Mënyra më e mirë kishte për të qenë sikur Qeveria e Kosovës të ketë mjete të mjaftueshme për rivitalizimin e “Kosovës B”, mirëpo duke pasur parasysh shuma të mëdha dhe projektet të cilat i ka kjo Qeveri para vetes, si projekte kapitale, ne do të thotë angazhohemi që të krijojmë kushte për investitorët privatë dhe “Kosova B” të shikohet mundësia të jepet me “Kosovën e Re” me qëllim që të fillojë zgjidhja e problemit të energjisë. Pra, si grup parlamentar e përkrahim strategjinë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, Besa e ka kërkuar fjalën, apo po ia jep kryetarit?

LULZIM ZENELI: Faleminderit!

Ne, si grup parlamentar, qëndrimin rreth strategjisë e kemi dhënë në debatin kur është mbajtur. Mirëpo, kur bëhet fjalë për rekomandimet e komisionit, kjo është ajo më e keqja çka mund të shpëtohet në bazë të këtyre rekomandimeve. Për ta nxjerrë në pah interesin e shtetit të Kosovës në këtë resurs strategjik, të cilin me gojën e plotë e kemi cekë për të satën herë.

Ajo çka duhet të theksohet, vetëm një çështje. Në qoftë se nisemi nga gjendja aktuale e këtyre kapaciteteve gjeneruese të energjisë, atëherë do të bindemi me një fakt se Kosova sot mund të prodhojë edhe 2000 edhe 3000 megavat, por prapë nuk do të ketë rrymë. Këtu kemi të bëjmë me logjikë të veprimit se çështja kryesore sot ekziston, kemi të bëjmë me shpërndarje dhe inkasim, i cili është problemi kyç i sistemit energjetik të vendit. Dhe ajo çka ne mund të themi sot, ministri e ceku se përqindjen e aksioneve të mundshme përcakton tregu ...

KRYETARI: Lus deputetët të kthehen në sallë, se do të votojmë pas fjalës së deputetit.

... Ne theksojmë se përqindjen e aksioneve, pavarësisht për cilin kapacitet bëhet fjalë, e përcakton ligji, e përcakton Kuvendi i Kosovës, e përcaktojnë institucionet kompetente.

Mendojmë se nëse hyjmë në aventura, që kemi të bëjmë me kapacitetet e “Kosovës B” dhe të kyçemi një pako tenderuese pa e definuar vlerën e aseteve të këtyre kapaciteteve, pa e nxjerrë Ligjin e privatizimit për “Kosovën B” dhe të gjitha kapaciteteve gjeneruese aktuale - është një aventurë shumë e rrezikshme, e cila do të krijojë obligime të mëdha jo vetëm sot, për këtë gjeneratë, por edhe për gjenerata të tjera.

Pra, jemi kundër të vendoset në një pako tenderuese “Kosova B”. Duhet shikohet që kjo çështje të trajtohet me ligj të veçantë, ashtu siç e kanë trajtuar të gjitha vendet e tjera të rajonit. Po, edhe tash po e themi atë që e kemi thanë më herët, se krejt ky dokument ashtu siç është trajtuar në fillim dhe po trajtohet tash - është në shërbim ekskluziv të interesave të grupeve, të klaneve të caktuara vendore dhe ndërkombëtare dhe nuk ka për bazë interesin nacional apo shtetëror të vendit.

Ne jemi kundër kësaj logjike dhe themi se është momenti i fundit që të ndalet një trend negativ, që Kosova të heqë dorë nga pronësia e saj, nga pronësia strategjike që ne po e vlerësojmë vazhdimisht. Nëse vazhdohet kështu, atë që e kemi thënë edhe më herët, do të jemi qiraxhi, Kosova do të jetë qiraxhi në resurset e saja dhe jemi kundër kësaj logjike, prandaj duhet të përkrahen të paktën rekomandimet e komisionit funksional, ajo çka mund të ndalet sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në sallë kemi 80 deputetë.

Të nderuar deputetë, ju e dini se debati ka përfunduar, prandaj ua dhashë rastin grupeve parlamentare dhe mendoj kjo u krye. Urdhëro! Fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë dëshiroj t’ju falënderoj të gjithëve për diskutimet dhe opinionet e juaja, të gjitha partitë politike, por edhe ministrat.

Ju e dini se kjo çështje nuk është që ka filluar dhe që po fillon sot. Është një projekt që ka filluar edhe më herët, por që në një formë apo në formë tjetër nga rrjedhat globale energjetike dhe ambientaliste, por edhe financiare i është imponuar Kosovës, Qeverisë së Kosovës të ridizajnojë këtë projekt, ku përfshihet edhe “Kosova B” në pakon e “Kosovës së Re”. Prandaj, të nderuar deputetë, Kabinet qeveritar, çështja është e votimit të Strategjisë me përfshirjen e “Kosovës B” në pakon e “Kosovës së Re”.

Rekomandimet, të cilat u prezantuan këtu, janë rekomandime të cilat u lexuan me vëmendje. U përmendën këtu edhe disa faktorë dhe rrethana të cilat edhe ju i dini shkëlqyeshëm, secili prej juve, edhe si parti politike, edhe si deputetë. Rezervat të cilat i kanë deputetë të caktuar i kuptoj edhe si dallime konceptuale, por jo si refuzim i projektit “Kosova e Re”.

Nuk mendoj që është në interesin e askujt nga ne as si shtet, as si institucione, as si qytetarë, as për të sotmen, as për të ardhmen që me ndonjë deklaram tonin kundër pakos apo projektit të strategjisë për ndërtimin e “Kosovës së Re” - Strategjisë energjetike ku

përfshihet edhe “Kosova B”, të largojmë konzorciumet prej më të fuqishmeve në sektorin energjetik, të largojmë me vendimin tonë investitorët në Republikën e Kosovës, kështu që dua të theksoj se është projekti prej më të seriozëve edhe në rajon, prandaj le ta zhvillojmë këtë projekt, ta bëjmë fuqi energjetike Kosovën në rajon, sipas standardeve dhe mundësive më të mira që kemi.

Ky proces është në agjendë dhe agjenda është të kalojë strategjia energjetike në Parlamentin e Kosovës dhe menjëherë të vazhdohet me realizimin e procedurave adekuate për procesin e fillimit të ndërtimit të projektit “Kosova e Re”. Këtu këtë e përmendi edhe ministri Shala, edhe ministrja e Energjetikës, e përmendi edhe Berimi dhe deputetët tjerë - shumica prej jush – sa i ka kushtuar Kosovës investimi në këto termocentrale deri më tani, ishin ndërtuar termocentrale të reja...

(Ndërhyrje e deputetit Tali, nuk dëgjohet për transkriptim)

...zoti Tali, keni mirëkuptim, se kush del të flasë, ti po flet. Mirë de, kur të vjen koha, del e bë replikë, fol çka të duash, nuk është asnjë problem, por së paku një edukatë elementare - dëgjoje tjetrin! Ne po dëgjojmë kur po flet ti, kurse ti po ndërhysh kur flet kryeministri, ministrat, deputetët. E di si enciklopedi je, po prit pak!

Rekomandimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, rekomandimi i këshilltarëve të transaksionit, i partnerëve ndërkombëtarë, e theksoj, i partnerëve ndërkombëtarë është i përbashkët me atë të institucioneve të Republikës së Kosovës që të kalojë ky projekt. E di se ka dilema të vazhdueshme për projekte të rëndësishme dhe është mirë që të diskutohen dhe duhet të diskutohen patjetër dhe ta marrin vulën e Parlamentit të Kosovës.

Unë jam i gatshëm të respektoj çdo vendim që merret në Parlamentin e Kosovës, por jam i bindur se është vendimi më i drejtë i mundshëm propozimi që e ka Qeveria e Kosovës, Ministria e Energjetikës, këshilltarët i transaksionit dhe këshillat e miqve dhe të partnerëve ndërkombëtarë. E kemi përkrahjen e krejt botës demokratike për këtë projekt. Nëse nuk e votojmë, e humbim përkrahjen e plotë dhe to të merremi me sanimin e pasojave për kohë të gjatë në sektorin e energjisë, e pa rregullimin e sektorit të energjisë, ju e dini, nuk ka as zhvillim ekonomik, as biznes, as krijim të vendeve të reja të punës. Nuk ka progres në shtetin tonë! Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar...
Ju lutem, debati ka përfunduar.

(Ndërhyrje e deputetit Tali, nuk dëgjohet për transkriptim)

Do të thotë, gati në tërësi kemi pajtueshmëri në mes strategjisë së propozuar nga Qeveria dhe rekomandimeve të komisionit, me përjashtim, nëse e keni dëgjuar mirë edhe kryeministrin, është pika 3 e rekomandimit, e cila thotë: “mospërfshirjen”, kurse Qeveria kërkon: “përfshirjen e “Kosovës B” në projektin” ose sipas Strategjisë, pika 11.25 e strategjisë.

(Reagim nga, salla nuk dëgjohej për transkriptim)

KRYETARI: Mirë de, të plotësohet kjo pikë. Do të thotë, kjo është dhe ne do të shkojmë sipas Rregullores, e votojmë Strategjinë me plotësimin që e tha ministrja.

Lus deputetë dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:
Prezent janë 81 deputetë, “për” janë 54 vota, 6 “kundër” dhe 2 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi miratoi dokumentin – Strategjia e energjisë për periudhën 2009 – 2018 me rekomandimet e komisionit, me plotësim të Rekomandimit 3.

Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:
Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës